



# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

[www.qpz.gov.al](http://www.qpz.gov.al)

**Nr.141**

**17 tetor**

**2011**

## P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Vendim i Kuvendit nr.127, datë 29.9.2011	Për zgjedhjen e Kryetarit të Komisionit të Autoritetit të Konkurrencës .....	6339
Vendim i Kuvendit nr.128, datë 29.9.2011	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin e Kuvendit nr.3, datë 16.9.2009 “Për caktimin e përbërjes së komisioneve të përhershme të Kuvendit”, të ndryshuar .....	6339
Vendim i Kuvendit nr.129, datë 6.10.2011	Për një shtesë në vendimin e Kuvendit nr.3, datë 16.9.2009 “Për caktimin e përbërjes së komisioneve të përhershme të Kuvendit”, të ndryshuar .....	6340
Dekret nr.7090 datë 30.9.2011	Për dhënie të shtetësisë shqiptare .....	6340
Dekret nr.7091 datë 30.9.2011	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	6341
Dekret nr.7097 datë 5.10.2011	Për lejim lënieje të shtetësisë shqiptare .....	6341
Vendim i KM nr.639, datë 7.9.2011	Për riorganizimin e Zyrës Kombëtare Tempus .....	6342
Vendim i KM nr.640, datë 14.9.2011	Për vendosjen e marrëdhënieve diplomatike ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Principatës së Monakos .....	6344
Vendim i KM nr.641, datë 14.9.2011	Për kompensimin e vlerës së taksës së biznesit të vogël, të përdorur për rimbursimin e pajisjeve fiskale e të taksimetrave, për 6 bashki dhe 10 komuna .....	6344

Vendim i KM nr.643, datë 14.9.2011	Për miratimin e strategjisë kombëtare sektoriale të shërbimeve të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve .....	6345
Vendim i KM nr.649, datë 14.9.2011	Për përcaktimin e listës së specialiteteve, nënspecialiteteve apo specialiteteve plotësuese për profesionet e rregulluara ....	6381
Vendim i KM nr.650, datë 14.9.2011	Për licencimin e akademisë së studimeve të aplikuara “REALD” .....	6382
Vendim i KM nr.651, datë 14.9.2011	Për licencimin e Akademisë Profesionale të Biznesit .....	6383
Vendim i KM nr.654, datë 14.9.2011	Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Pogon, të qarkut të Gjirokastrës	6384
Udhëzim i METE nr.622, datë 7.9.2011	Për regjistrimin e titujve në shoqërinë “Qendra e Rregjistrimit të Aksioneve” sh.a. Tiranë .....	6385
Vendim i ERE nr.82, datë 13.9.2011	Për fillimin e procedurave për përcaktimin e tarifës së prodhimit të energjisë elektrike nga KESH sh.a., për periudhën e tretë rregullatore .....	6386
Vendim i ERE nr.83, datë 13.9.2011	Për fillimin e procedurave për përcaktimin e tarifës së energjisë elektrike për furnizuesin publik me shumicë për periudhën e tretë rregullatore .....	6387
Vendim i ERE nr.84, datë 13.9.2011	Për fillimin e procedurave për përcaktimin e tarifës së transmetimit të energjisë elektrike nga OST sh.a., për periudhën e tretë rregullatore .....	6387
Vendim i ERE nr.85, datë 13.9.2011	Për fillimin e procedurave për përcaktimin e tarifës së shpërndarjes së energjisë elektrike për periudhën e tretë rregullatore .....	6388
Vendim i ERE nr.86, datë 13.9.2011	Për fillimin e procedurave për përcaktimin e tarifës së furnizimit publik me pakicë të energjisë elektrike nga “CEZ shpërndarje” sh.a., për konsumatorët tariforë për periudhën e tretë rregullatore .....	6389
Kërkesë e MPPT nr.4001/2, datë 27.9.2011	Për shpronësim për interes publik të pasurive të paluajtshme pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Ndërtim k/rruga nacionale Laç-Patok (vazhdim)” .....	6389
	Kërkesë për shpalljen të zhdukur të shtetasit Krenar Ymeraj	6390

**VENDIM**  
**Nr.127, datë 29.9.2011**

**PËR ZGJEDHJEN E KRYETARIT TË KOMISIONIT**  
**TË AUTORITETIT TË KONKURRENCËS**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, të nenit 21 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, të ndryshuar, si dhe të nenit 111 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e një grupi deputetësh,

KUVENDI  
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

- I. Zonja Lindita Milo (Lati) zgjidhet Kryetare e Komisionit të Konkurrencës.
- II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE  
**Jozefina Topalli (Çoba)**

**VENDIM**  
**Nr.128, datë 29.9.2011**

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN E KUVENDIT NR. 3, DATË**  
**16.9.2009 “PËR CAKTIMIN E PËRBËRJES SË KOMISIONEVE TË PËRHERSHME TË**  
**KUVENDIT”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 78 pika 1 të Kushtetutës, të neneve 55 pika 1 dhe 21 pikat 1 dhe 2 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Konferencës së Kryetarëve, pas marrëveshjes së Kryetares së Kuvendit me Kryetarin e Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike dhe Kryetarin e Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste,

KUVENDI  
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në vendimin e Kuvendit nr. 3, datë 16.9.2009 “Për caktimin e përbërjes së komisioneve të përhershme të Kuvendit”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

I. Deputetja Rajmonda Bulku largohet nga Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut dhe caktohet anëtare në Komisionin për Integrimin European.

II. Deputeti Viktor Gumi largohet nga Komisioni për Integrimin European.

III. Deputeti Ramiz Çobaj caktohet anëtar në Komisionin për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut dhe në Komisionin për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin.

IV. Deputeti Arion Muçaj caktohet anëtar në Komisionin për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin.

V. Deputeti Ndrec Deda caktohet anëtar në Komisionin për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin.

VI. Deputeti Eduard Shalsi caktohet zëvendëskryetar në Komisionin për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin në vend të deputetit Ilir Beqja.

VII. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARE**  
**Jozefina Topalli (Çoba)**

**VENDIM**  
**Nr.129, datë 6.10.2011**

**PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN E KUVENDIT NR. 3, DATË 16.9.2009 “PËR  
CAKTIMIN E PËRBËRJES SË KOMISIONEVE TË PËRHERSHME TË KUVENDIT”, TË  
NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 78 pika 1 të Kushtetutës, të neneve 55 pika 1 dhe 21 pikat 1 dhe 2 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Konferencës së Kryetarëve,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

Në vendimin e Kuvendit nr. 3, datë 16.9.2009 “Për caktimin e përbërjes së komisioneve të përhershme të Kuvendit”, të ndryshuar, bëhet kjo shtesë:

I. Deputeti Shpëtim Idrizi caktohet anëtar në Komisionin për Politikën e Jashtme.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARE**  
**Jozefina Topalli (Çoba)**

**DEKRET**  
**Nr.7090, datë 30.9.2011**

**PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, pika “c”, të nenit 93 të Kushtetutës, si dhe të nenit 9, pika 7, dhe nenit 20 të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998, “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar, bazuar në propozimin e Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve,

**DEKRETOJ:**

Neni 1

I jepet shtetësia shqiptare me kërkesë të tij personit të mëposhtëm:

Mërgim Xhavid Bajraktari

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

**PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**  
**Bamir Topi**

**DEKRET**  
**Nr.7091, datë 30.9.2011**

**PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, pika “c”, dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe të nenit 9, pika 7, dhe nenit 20 të ligjit nr.8389, datë 5.8.1998 “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar, bazuar në propozimin e Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve,

**DEKRETOJ:**

Neni 1

I jepet shtetësia shqiptare me kërkesë të tij personit të mëposhtëm:

Arbnor Femi Fejzullahi

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

**PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**  
**Bamir Topi**

**DEKRET**  
**Nr.7097, datë 5.10.2011**

**PËR LEJIM LËNIEJE TË SHTETËSISË SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, pika “c”, dhe nenit 93 të Kushtetutës, të neneve 15, 19 dhe 20 të ligjit nr.8389, datë 5.08.1998 “Për shtetësinë shqiptare”, i ndryshuar, bazuar edhe në propozimin e Ministrit të Brendshëm,

**DEKRETOJ:**

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

1. Enela Selim Markja (Shehu)
2. Herrlin Petrit Markja
3. Luis Petrit Markja
4. Sonila Dritor Taka
5. Gabriel Albson Albert Krasniqi
6. Blerina Illi Jorgaqi-Miftari (Jorgaqi)
7. Manjola Luan Dhoska (Omeri)
8. Valerjana Angjelin Karma
9. Megjana Fatos Shehu
10. Erjola Gëzim Kërluku
11. Majlinda Asllan Dervishi (Doku)
12. Frankel Maksim Maçi
13. Xhilda Ali Ago-Feser (Ago)
14. Gerhard Arben Dukati

15. Vilma Veis Tare (Ademoski)
16. Edlioni Vangjel Stoja
17. Estrela Edlioni Stoja
18. Alfred Ajdin Brasha
19. Edlira Vladimir Shehu
20. Adelaida Gezim Kajmeni
21. Genci Ismet Berberi
22. Kledia Pellumb Kumbaro
23. Mirela Flamur Muço
24. Namik Hysen Markja
25. Denis Arian Hetaj
26. Rosi Roland Xhumaqi
27. Albana Qerim Korba
28. Adela Mehmet Eilzer (Çausi)
29. Edmond Ndue Bardhaj

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË  
**Bamir Topi**

**VENDIM**  
**Nr.639, datë 7.9.2011**

**PËR RIORGANIZIMIN E ZYRËS KOMBËTARE TEMPUS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 12 të ligjit nr.9000, datë 30.1.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Riorganizimin e Zyrës Kombëtare Tempus (ZKT), si person juridik, jobuxhetor, në varësi të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, e cila përfaqëson palën shqiptare pranë Komisionit Europian (KE) për Programin Tempus, në kuadër të marrëveshjes së nënshkruar për këtë qëllim.

2. Zyra Kombëtare Tempus (ZKT), nëpërmjet programit Tempus, pjesë e “Programit me shumë përfitues në kuadrin e komponentit të IPA-s “Asistenca e tranzicionit dhe mbështetjes institucionale””, mbështet reformimin e institucioneve të arsimit të lartë, ndihmon përafrimin dhe harmonizimin e tyre me zhvillimet brenda BE-së, që rrjedhin nga Agjenda e Lisbonës, procesi i Bolonjës dhe Strategjia Europa 2020.

3. Zyra Kombëtare Tempus (ZKT), në bazë dhe në zbatim të marrëveshjes së financimit, ndërmjet qeverisë shqiptare dhe Komisionit Europian, për programin me shumë përfitues për Tempus, në kuadër të komponentit të IPA-s “Asistenca e tranzicionit dhe mbështetjes institucionale”, ushtron këto funksione”:

- a) Asiston KE-në për promovimin dhe rritje e vizibilitetit të programit Tempus;
- b) Përpunon, promovon dhe shpërndan në të gjitha institucionet e arsimit të lartë (IAL), informacionin dhe dokumentacionin e programit Tempus, të përgatitur nga Agjencia Ekzekutive për Arsimin, të drejtat Audiovizuale dhe Kulturën (EACEA), organ publik i Komisionit Europian;

c) Këshillon, informon dhe ndihmon të gjithë aplikantët dhe IAL-të e përfshira në projektet Tempus për çështje që lidhen me implementimin dhe zbatimin e detyrimeve që lindin nga kontratat me EACEA-në;

ç) Kryen monitorimin e zbatimit të projekteve Tempus dhe raporton pranë EACEA-së për vërejtjet, si dhe jep rekomandimet përkatëse;

d) Kontribuon dhe jep vlerësimin për projektet e paraqitura në kuadër të programit Tempus, në përputhje me strategjitë dhe prioritetet kombëtare dhe ia paraqet këtë vlerësimin EACEA-së;

dh) Nënshkruan kontratën me EACEA-në për implementimin e programit Tempus në nivel kombëtar dhe zbaton detyrimet që rrjedhin prej saj;

e) Mbështet dhe koordinon veprimtaritë e Grupit Kombëtar të Ekspertëve për reformat e arsimit të lartë, HERE (Higher Education Reform Experts), të cilët kanë rol këshillues dhe mbështetës për arritjen e objektivave të programit Tempus;

ë) Administron buxhetin për funksionimin e ZKT-së në Shqipëri, i cili alokohet nga EACEA-ja.

4. Struktura dhe rregullorja e funksionimit të ZKT-së miratohen me urdhër të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, në përputhje me termat e referencës së KE-së për zyrat kombëtare Tempus, pas konsultimit me EACEA-në.

5. Drejtor i Zyrës Kombëtare Tempus (ZKT) është koordinatori lokal i programit Tempus, i cili emërohet nga EACEA-ja, si kandidaturre e përzgjedhur nëpërmjet procedurave të saj të brendshme në konsultim me Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës.

6. Specialistët e ZKT-së përzgjidhen nga EACEA-ja, nëpërmjet procedurave të saj të brendshme, në bashkëpunim me koordinatorin lokal të ZKT-së. Marrëdhëniet e punës së specialistëve të ZKT-së rregullohen në bazë të Kodit të Punës të Republikës së Shqipërisë.

7. Fondi i pagave për specialistët do të mbulohet nga buxheti i ZKT-së, me fondet e programit Tempus, të alokuara nga EACEA-ja, ndërsa paga mujore e drejtorit, sipas strukturës dhe në masën e përcaktuar në lidhjet nr.1 dhe nr.2, klasa II-B, që i bashkëlidhen vendimit nr.545, datë 11.8.2011, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në Kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, administratën e Presidentit, Kuvendit, Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Prokurorinë e Përgjithshme, disa institucione të pavarura, institucionet në varësi të Këshillit të Ministrave/Kryeministrit, institucionet në varësi të ministrave të linjës dhe administratën e prefektit”, paguhet nga buxheti i ZKT-së dhe përballohet nga fondet e rialokuara, si kosto lokale nga buxheti i miratuar për Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, zëri shpenzime personeli”.

8. Vendimi nr.485, datë 11.9.1995 i Këshillit të Ministrave “Për funksionet e programit Tempus” i ndryshuar, shfuqizohet.

9. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Zyra Kombëtare Tempus, në Shqipëri, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

**VENDIM**  
**Nr.640, datë 14.9.2011**

**PËR VENDOSJEN E MARRËDHËNIEVE DIPLOMATIKE NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE PRINCIPATËS SË MONAKOS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 6 të ligjit nr.9095, datë 3.7.2003 “Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Vendosjen e marrëdhënieve diplomatike ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Principatës së Monakos.
2. Ngarkohet Ministria e Punëve të Jashtme për zbatimin e këtij vendimi.  
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

**VENDIM**  
**Nr.641, datë 14.9.2011**

**PËR KOMPENSIMIN E VLERËS SË TAKSËS SË BIZNESIT TË VOGËL, TË PËRDORUR PËR RIMBURSIMIN E PAJISJEVE FISKALE E TË TAKSIMETRAVE, PËR 6 BASHKI DHE 10 KOMUNA**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15 të ligjit nr.10 355, datë 2.12.2010 “Për buxhetin e vitit 2011”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Kompensimin e vlerës së taksës së biznesit të vogël, të përdorur për rimbursimin e vlerës së pajisjeve fiskale e të taksimetrave, për njësitë e qeverisjes vendore, konkretisht, për 6 (gjashtë) bashki dhe 10 (dhjetë) komuna, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
2. Fondi, në vlerën 27 677 213 lekë (njëzet e shtatë milionë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e dyqind e trembëdhjetë) lekë përballohet nga Fondi i Kontigjencës, i miratuar në buxhetin e vitit 2011.
3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe njësitë e qeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.  
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

Lidhja nr.1

<b>Nr.</b>	<b>Emri i NJQV-së</b>	<b>Vlera (në lekë)</b>
1	Bashkia Divjakë	1,337,387
2	Bashkia Maliq	626,150
3	Bashkia Bajram Curri	589,625
4	Bashkia Shkodër	14.454,461
5	Bashkia Himarë	5,002,000



6	Bashkia Përrenjas	2,030,625
7	Komuna Mollaj (Korçë)	218,700
8	Komuna Kutalli (Berat)	155,250
9	Komuna Gjocaj (Elbasan)	55,625
10	Komuna Q.Librazhd	396,000
11	Komuna Cerravë	248,430
12	Komuna Mollas (Elbasan)	293,260
13	Komuna Gore (Korçë)	13,000
14	Komuna Liqenas	33,000
15	Komuna Gosë	1,980,000
16	Komuna Shupenzë	243,700
	<b>Shuma</b>	<b>27,677,213</b>

**VENDIM**  
**Nr.643, datë 14.9.2011**

**PËR MIRATIMIN E STRATEGJISË KOMBËTARE SEKTORIALE TË SHËRBIMEVE TË FURNIZIMIT ME UJË DHE KANALIZIMEVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e Strategjisë Kombëtare Sektoriale të Shërbimeve të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Ngarkohet Ministria e Punëve Publike dhe Transportit për ndjekjen dhe monitorimin e zbatimit të kësaj strategjie, në bashkëpunim me institucionet e përcaktuara në veprimet prioritare të saj.
3. Vendimi nr.706, datë 16.10.2003 i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare të Furnizimit me Ujë dhe të Sanitetit”, shfuqizohet.  
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

**STRATEGJIA KOMBËTARE SEKTORIALE**  
**E SHËRBIMEVE TË FURNIZIMIT ME UJË DHE KANALIZIMEVE 2011-2017**

Hyrje

Kjo strategji e sektorit të ujësjellës-kanalizimeve të Republikës së Shqipërisë, për periudhën 2011-2017, është përgatitur me qëllim prezantimin e vizionit, objektivave të misionit dhe planeve të veprimit të Shqipërisë në mënyrë të qartë, specifike, sasiore dhe kohore, së bashku me përgjegjësitë që i takojnë çdo institucioni. Kjo qasje, disi ndryshe për një strategji sektoriale, ka për qëllim të mos lërë vend për paqartësi apo keqkuptime në lidhje me drejtimin dhe objektivin e saj.

Shqipëria, si bashkësponsorizuese e Rezolutës së Kombeve të Bashkuara për ta bërë “aksesin në ujë të pijshëm të sigurt dhe kanalizime të drejta të njeriut”, është e angazhuar të demonstrojë, me fjalë dhe me vepra, se një vend i vogël në zhvillim mund t’i përgjigjet çështjes globale dhe të bëjë atë çka i takon për t’u garantuar barazi të gjithë qytetarëve të saj, sa i përket të drejtave të njeriut në lidhje me ujën e pijshëm dhe kanalizimet.

Shqipëria e vlerëson rolin unik të ujit të pijshëm të sigurt dhe të kanalizimeve në mbështetje të cilësisë së jetës dhe zhvillimit ekonomik në vendet me të ardhura të ulëta dhe të mesme. Shqipëria kupton, gjithashtu, edhe karakterin natyral dhe monopolist të ofrimit të këtyre shërbimeve publike

thelbësore, si dhe nevojën për barazi dhe drejtësi mes të gjithë pjesëmarrësve në këtë sektor. Shqipëria, gjithashtu, i qëndron realitetit praktik se uji duhet të trajtohet në mënyrë të tillë që të vlerësohet si produkt, të prodhohet me një kosto dhe të konsumohet kundrejt një çmimi.

Shqipëria ka ecur pa u lodhur dhe pa u lëkundur drejt decentralizimit të pushtetit dhe paralelisht me të, drejt transferimit të pronësisë dhe përgjegjësisë për shërbimet e furnizimit me ujë dhe kanalizimeve të ujërave të zeza drejt pushtetit vendor. Ky dokument strategjie është në mbështetje të plotë të procesit të decentralizimit, duke njohur dhe mbështetur njëkohësisht të gjithë synimin e rezolutës së Kombeve të Bashkuara. Në këtë aspekt, Qeveria Shqiptare do të forcojë institucionet e saj qendrore për të orientuar dhe udhëzuar investimet prioritare në këtë sektor; do të mbikëqyrë performancën e sektorit; do të lehtësojë strategjitë optimizuese për rritjen e efikasitetit të sektorit; si dhe do të rregullojë çmimin dhe cilësinë e shërbimit në këtë sektor për të mirën e të gjithë qytetarëve dhe të drejtës së tyre të natyrshme si qenie njerëzore.

Qeveria Shqiptare vlerëson ndërmarrjet e ujësjellës-kanalizimeve në vend, profesionistët dhe punonjësit me përvojë që i vënë në punë dhe i mirëmbajnë ato, si edhe këshillat mbikëqyrës që mbikëqyrin këto ndërmarrje në emër të pushtetit vendor, për të ecur përpara, në mënyrë që Shqipëria të mund të mbajë premtimin që u ka bërë qytetarëve për ofrimin e këtyre shërbimeve thelbësore.

Qeveria Shqiptare e pranon se është kujdestare e një burimi natyror që s'njeh shok në botë. Duke e kuptuar këtë fakt, strategjia synon të japë kontributin e vet në mbrojtjen dhe administrimin e këtyre burimeve natyrore jo vetëm sot, por për të gjithë brezat që do të vijnë. Për këtë arsye, strategjia është hap madhor në këtë drejtim, dhe realizimi i saj do të shoqërojë realizimin e premtimit se në Shqipëri do të ketë ujë të pijshëm të sigurt dhe kanalizime për të gjithë.

## KAPITULLI 1 GJENDJA AKTUALE E SEKTORIT

Ky kapitull i strategjisë është një përmbledhje e shkurtër e gjendjes aktuale të sektorit të shërbimeve të ujësjellës-kanalizimeve në Shqipëri, dhe si një pikënisje për zhvillimin e vizionit, misionit, ndërhyrjeve prioritare dhe të planeve të veprimit, të përshkruar me hollësi në kapitujt vijues. Ky kapitull nuk ka për qëllim të jetë shterues, për sa i përket përmbajtjes, pasi i gjithë informacioni që përmban mund të gjendet i detajuar në raporte mbështetëse dhe në dokumente zyrtare. Ky kapitull është strukturuar dhe është hartuar në mënyrë të tillë që të paraqesë një bazë faktike për strategjinë e sektorit që Republika e Shqipërisë ka vendosur të zbatojë me qëllim përmirësimin e matshëm të performancës së këtij sektori.

### 1.1 Popullsia: Statistikat, emigrimi dhe varfëria

Strategjia ka për qëllim të përmirësojë shërbimet e furnizimit me ujë dhe kanalizimeve për qytetarët shqiptarë, si dhe të mbështesë zhvillimin ekonomik të vendit, bazuar në performancën e një shërbimi infrastrukturor thelbësor. Për të avancuar drejt përmbushjes së këtij qëllimi, është shumë e rëndësishme që strategjia të përcaktojë disa të dhëna dhe informacione bazë që lidhen me popullsinë, mënyrat e ndryshimit të saj, si edhe me gjendjen ekonomike të popullsisë.

#### 1.1.1 Gjeografia dhe popullsia

Republika e Shqipërisë gjendet në gadishullin e Ballkanit në Europën Juglindore dhe ka një sipërfaqe prej 28,748 kilometrash katrorë. Në veriperëndim kufizohet me Malin e Zi me një vijë kufitare prej 172 km, në verilindje me Kosovën me një vijë kufitare 115 km, në lindje me Maqedoninë me një vijë kufitare 151 km dhe në jug e juglindje me Greqinë me një vijë kufitare 282 km. Në perëndim laget nga deti Adriatik dhe deti Jon, me një vijë bregdetare prej 487 km. Shqipëria ka klimë kontinentale me dimër të ftohtë dhe verë të nxehtë. Shqipëria ka burime të bollshme ujore, konkretisht 8,600 m<sup>3</sup> për frymë në vit.

Sa i përket popullsisë së përgjithshme me banim brenda territorit të Shqipërisë, nuk ka një regjistrim zyrtar të kohëve të fundit. Për të përcaktuar popullsinë e përgjithshme, si në qytet ashtu edhe në fshat, në mbështetje të hartimit të strategjisë, janë marrë parasysh burime të ndryshme informacioni.

Sipas Ministrisë së Brendshme, bazuar në të dhënat e siguruar nga Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile, popullsia e përgjithshme e regjistruar në Shqipëri është 4 200 000 banorë. Megjithatë, kjo shifër përfshin edhe shtetas shqiptarë që kanë emigruar dhe që jetojnë përgjithmonë ose kryesisht jashtë Shqipërisë. Numri i personave që mendohet t'i përkasin kësaj kategorie është afërsisht 700 000 vetë.

Sipas Institutit të Statistikës (INSTAT), popullsia zyrtare e Shqipërisë që jeton në vend sipas regjistrimit të popullsisë dhe banesave të vitit 2001 ka qenë 3 069 275 banorë. Në vitin 2010, popullsia e Shqipërisë sipas INSTAT ishte 3 195 417 banorë, kurse dendësia ishte rreth 111 persona për kilometër katror.

Që prej vitit 2005, Republika e Shqipërisë ka menaxhuar programin e monitorimit të treguesve të punës dhe vlerësimit krahasues për sektorin e ujësjellës-kanalizimeve dhe deri më 31 dhjetor 2010, ka përmbyllur pesë cikle të dhënash vjetore. Ky program përfshin të pesëdhjetë e tetë (58) ndërmarrjet e ujësjellës-kanalizimeve në mbarë vendin. Sipas njësisë së monitorimit, popullsia që jeton brenda zonave urbane nën administrimin e ndërmarrjeve të ujësjellës-kanalizimeve është 2 185 685 banorë, kurse në zonat rurale nën administrimin e tyre është 1 047 979 banorë. Pra, sipas këtyre të dhënave, popullsia totale e shërbyer është 3 233 664 banorë. Por ndërmarrjet e ujësjellës-kanalizimeve që i raportojnë njësisë së monitorimit nuk përfaqësojnë të gjithë territorin fizik të Shqipërisë. Disa komuna dhe fshatra nuk janë nën administrimin e asnjë ndërmarrjeje ujësjellësi dhe/apo kanalizimesh të regjistruar në bazën e të dhënave të kësaj njësie, dhe operojnë të pavarura, pa licencën e Komisionit Rregullator të Ujit.

Strategjia do ta konsiderojë popullsinë e përgjithshme të vitit bazë 2010 rreth 3,4 milionë banorë, meqë strategjia për ujësjellës-kanalizimet në Shqipëri do të monitorohet dhe do të përditësohet çdo vit, dhe meqë INSTAT-i do të fillojë në fillim të muajit prill 2011, zbatimin e një projekti madhor që është “Regjistrimi i popullsisë dhe banesave” (REPOB-AL 2011) që ka për qëllim realizimin e një baze të saktë të dhënash për popullsinë.

Bazuar në informacionet dhe analizat e tendencave të realizuara nga INSTAT-i, popullsia në të gjithë Shqipërinë parashikohet të rritet ngadalë me 0.4% në vit për periudhën 2001-2021.

#### 1.1.2 Migrimi i popullsisë dhe ndikimi te strategjia

Çështja e popullsisë në Shqipëri është e rëndësishme për hartimin e një strategjie për sektorin e shërbimeve të ujësjellës-kanalizimeve. Ndryshe nga vendet më të zhvilluara me popullsi relativisht statike, shkallë rritjeje natyrale të parashikueshme dhe me zhvendosje të popullsisë drejt zonave më të urbanizuara sipas disa modeleve historike, popullsia e Shqipërisë ka pasur zhvendosje shumë më të mëdha, ku ndërthuret emigrimi në vende të huaja me migrimin e brendshëm më të madh sesa “normalja” nga zonat rurale drejt zonave urbane apo gjysmë urbane.

##### 1.1.2.1 Vështrim i përgjithshëm i migrimit në Shqipëri

Migrimi i popullsisë në Shqipëri ka qenë një fenomen i vazhdueshëm që në fillim të vitit 1990. Edhe pse niveli i migrimit ka pasur luhajtje në të dyja dekadat e fundit, vërehet tendencë në rritje me kalimin e kohës. Ndryshimet politike e demokratike në vend në fillim të viteve '90, çuan në një sërë ndryshimesh ekonomike dhe shoqërore. Një numër i konsiderueshëm shqiptarësh u zhvendosën brenda vendit nga zonat e pazhvilluara drejt atyre të zhvilluara, ose u larguan jashtë vendit në kërkim të mundësive më të mira ekonomike dhe një standardi më të lartë jetese.

Studimet kanë treguar se deri në vitin 2005, të paktën 1 ndër 5 të rritur janë zhvendosur brenda vendit, dhe se të paktën 1 ndër 3 familje ka pasur një anëtar të larguar jashtë shtetit (Banka Botërore, 2007). Studimet e kohëve të fundit kanë treguar se pjesa më e madhe e migrantëve në Shqipëri zhvendosen vetëm si individë dhe jo familjarisht. Midis viteve 1990 dhe 2004, vetëm 5% e familjeve migruese janë shpërngulur familjarisht si e tërë brenda ose jashtë Shqipërisë (Banka Botërore, 2007).

Kushtet e vështira të jetesës dhe rritja e ngadaltë ekonomike në zonat malore të vendit detyruan shumë individë dhe familje të tëra të zhvendosen drejt zonave më të zhvilluara të Shqipërisë për kushte më të mira jetese. Sipas “Anketës së matjes së nivelit të jetesës 2002” (INSTAT, UNDP, Banka Botërore, 2009), pothuajse gjysma (45%) e popullsisë në këto zona malore jetonte nën nivelin e varfërisë në vitin 2002.

Përqindja më e lartë e migrantëve dhe e emigrantëve është nga zonat bregdetare dhe qendrore (përkatësisht 42% dhe 41%). Sipas INSTAT-it, në vitin 2008 popullsia totale e këtyre dy zonave përbën pjesën më të madhe të popullsisë në Shqipëri (përkatësisht 33% dhe 42%). Në lidhje me migrimin e brendshëm, 44,6% e migrantëve janë nga zona bregdetare, 38.1% nga zona qendrore, 11.8% nga zonat malore dhe vetëm 5.5% nga Tirana urbane.

Migrimi ka ndikuar në strukturën e familjes. Në total, 3% e të gjithë migrantëve kanë lënë pas bashkëshorten ose bashkëshortin në familjet e origjinës. Si migrimi i brendshëm, edhe emigracioni shfaqin modele të ngjashme.

#### 1.1.2.2 Tendencat e migrimit

Para përmbysjes së regjimit në fillimin e viteve '90, lëvizjet e brendshme të popullsisë kanë qenë shumë të pakta në Shqipëri; kufijtë ishin të mbyllur dhe praktikisht nuk kishte asnjë lloj lëvizjeje jashtë vendit. Me rënien e regjimit të vjetër dhe hapjen e kufijve, pati një eksod masiv të shqiptarëve, kryesisht meshkuj, të cilët kërkuan azil në shumë ambasada të huaja dhe u pranuan më vonë në vendet përkatëse. Shumë emigruan nga deti dhe toka drejt vendeve fqinje, si Italia dhe Greqia.

Gjatë periudhës 2001-2005 pati një rritje të qëndrueshme të migrimit dhe të emigrimit, si të meshkujve, ashtu edhe të femrave. Gjatë periudhës 2005-2007, vazhdoi i njëjti model për meshkujt, dhe përqindja e emigrantëve vazhdoi të jetë më e lartë sesa e migrantëve të brendshëm. Për të njëjtën periudhë (2005-2009), migrimi dhe emigrimi për femrat u stabilizua dhe përqindja e femrave që migronin dhe të atyre që emigronin ishte pak a shumë e njëjtë. Nga fundi i vitit 2008, afërsisht një milion vetë, ose rreth 25% e shtetasve shqiptarë dhe më shumë se 35% e fuqisë punëtore, mendohet se jetonin jashtë vendit.

#### 1.1.3 Varfëria në Shqipëri

Megjithëse pranohet gjerësisht se varfëria është një gjendje me shumë më tepër dimensione sesa vetëm dimensionin e të ardhurave, është e vështirë të masësh aspektet e varfërisë që nuk lidhen me të ardhurat. Prandaj, njësia më e zakonshme e matjes së varfërisë është ajo e varfërisë në të ardhura. Varfëria në të ardhura përkufizohet si mungesë të ardhurash të mjaftueshme për të plotësuar nevojat minimale për konsum. Niveli minimal i të ardhurave zakonisht quhet "kufiri i varfërisë".

Kufiri absolut i varfërisë është një standard që shpreh sa para i duhen një familjeje për të plotësuar nevojat bazë. Kufiri absolut i varfërisë në Shqipëri është përcaktuar në masën 4,891 lekë për person në muaj (rreth 48 USD). Bazuar në këtë matje, 1/4 e popullsisë shqiptare ose afërsisht 780 000 vetë jetojnë nën kufirin e varfërisë. Varfëria ekstreme shkon deri në rreth 150 000 persona, ose pothuaj 5% e popullsisë, të cilët nuk janë në gjendje të plotësojnë as nevojat bazë për ushqim.

Shumica e të varfërve jetojnë në zonat rurale. Përmasat e varfërisë në zonat rurale janë ndjeshëm më të larta sesa në zonat urbane. Statistikat tregojnë se incidenca e varfërisë është pothuajse 3 herë më lartë në zonat rurale sesa në Tiranë, dhe 2 herë më e lartë sesa në zonat urbane. Varfëria më e ulët gjendet në Tiranë, ku hendeuku i varfërisë është vetëm 1.6% krahasuar me 2.6% në qytetet e tjera dhe 5.3% në zonat rurale. Gjithashtu, ashpërsia e varfërisë është dy herë më e lartë në zonat rurale sesa në qytete dhe pothuajse 4 herë më e lartë sesa në Tiranë.

Shqipëria ka pasur një performancë të fuqishme ekonomike në periudhën 2005-2009, me rritje mesatare vjetore mbi 7% për pjesën më të madhe të kësaj periudhe. Inflacioni qëndroi në nivelin 4% ose më pak; eksportet dhe importet u rritën në mënyrë të qëndrueshme; llogaria korente dhe deficitet me financim të brendshëm u përmirësuan ndjeshëm. Në 5 vitet e fundit janë zbatuar disa reforma strukturore që kanë përfshirë sistemin bankar, reformën e tokës dhe privatizimin. Bazuar në këtë performancë ekonomike dhe në reformat strukturore, Shqipëria ka arritur nivelin e të ardhurave mujore mesatare prej 38 141 lekë për familje (rreth 381 USD) ose të ardhura mesatare mujore individuale prej 10 884 lekë (rreth 108 USD). Pothuajse të gjitha ndërmarrjet e vogla dhe të mesme shtetërore janë privatizuar dhe është bërë një përparim i ndjeshëm në privatizimin e sektorëve strategjikë, si telekomunikacioni. Pavarësisht performancës ekonomike mbresëlënëse, varfëria në Shqipëri ka mbetur e lartë dhe të ardhurat për frymë janë ndër më të ulëtat mes ekonomive në tranzicion.

I vetmi program i vërtetuar kundër varfërisë është programi i “Ndhmës ekonomike”. Ai ka për qëllim mbështetjen e familjeve rurale me shumë pak tokë dhe familjeve pa burime të ardhurash. Ky program është ngritur në vitin 1993 si përgjigje ndaj papunësisë së vazhdueshme dhe kaosit shoqëror në rritje pas rënies së regjimit komunist. Përfituesit më të mëdhenj të ndihmës sociale nga ky program kanë qenë familjet rurale (16.5% krahasuar me 8.5% urbane) dhe familjet e zonave malore, pasuar nga Shqipëria e Mesme, zona bregdetare dhe më në fund Tirana. Niveli i përfitimit për familje ishte rreth 2 113 lekë/muaj (rreth 21 USD).

Varfëria në Shqipëri mbart dimensione hapësinore dhe rajonale, ku zonat rurale në rajonet malore janë vazhdimisht më të varfra sesa pjesa tjetër e vendit, sipas të gjitha përkufizimeve të varfërisë.

Strategjia kombëtare për zhvillim ekonomik dhe social ishte e para Strategji kombëtare për zhvillim që trajtonte qartë problemin e varfërisë. Pastaj u pasua nga Strategjia kombëtare për zhvillim dhe integrim (SKZHI) 2007-2013, që parashikon ndërhyrje me politika që përmirësojnë arsimin, kujdesin shëndetësor dhe infrastrukturën, duke rritur përgjegjshmërinë publike dhe pjesëmarrjen publike në vendimmarrjen për fuqizimin e të varfërve.

#### 1.1.4 Popullsia, migrimi dhe varfëria në kuadrin e periudhës së planifikimit

Në përqasjen e saj për të hartuar strategjinë e sektorit, Qeveria ka marrë parasysh çështjet e mëposhtme që kanë lidhje me popullsinë, migrimin dhe varfërinë, të cilat duhet të adresohen në periudhën e planifikimit:

- Vendosjen e të gjithë kërkesës për ujë dhe nevojave të mbulimit me shërbim për një popullsi banuese totale në Republikën e Shqipërisë prej 3.4 milionë vetash, me një rritje vjetore prej 0.4%.

- Migrimi i brendshëm do të vazhdojë gjatë periudhës së planifikimit dhe popullsia migratore do të vendoset kryesisht në zonat rurale përreth zonave aktuale urbane. Për momentin, këto zona rurale në përgjithësi nuk kanë shërbim publik me ujë të pijshëm dhe kanalizime. Do të duhen investime të konsiderueshme për ofrimin e këtyre shërbimeve bazë.

- Nevojitet një program me synime të qarta për t’u ofruar subvencione sociale individëve dhe familjeve që jetojnë nën kufirin e varfërisë, të përcaktuar nga shteti, në mënyrë që ndërmarrjeve t’u mundësohet të operojnë mbi baza tregtare pa aplikim të subvencioneve të shumta në favor të kategorive të ndryshme.

#### 1.2 Burimet ujore

Burimet e ujit të pijshëm përbëjnë një burim madhor për vendin. Sasia mesatare e ujit të pijshëm për frymë është 8,700 metra kub në vit, një ndër më të lartat në Europë. Burimet e ujit të pijshëm në vend ekzistojnë në formën e burimeve natyrore, të lumenjve, të liqeneve dhe të ujëmbledhësve të ujërave nëntokësore. Furnizimi me ujë të pijshëm vjen kryesisht nga burimet natyrore dhe burimet ujore nëntokësore, përveç zonës metropolitane të Tiranës, e cila një pjesë të furnizimit e merr nga burimet ujore malore që janë devijuar për të krijuar një rezervuar sipërfaqësor furnizimi me ujë që rrjedhimisht duhet trajtuar.

Burimet ujore në Shqipëri janë të shpërndara në mënyrë hidrografike në gjashtë (6) basene ujore, të cilat rrjedhin të gjitha në drejtimin perëndimor ose veriperëndimor në të gjithë vendin dhe që kanë sistemet e tyre kryesore nga veriu në jug si vijon: lumenjtë Drini dhe Buna, lumi Mat, lumenjtë Ishëm dhe Erzen, lumi Shkumbin, lumi Seman dhe lumi Vjosë. Është e rëndësishme të theksohet se këto sisteme lumenjsh kullojnë jo vetëm tokën në Shqipëri, por edhe pjesë të mëdha zonash të banuara të Maqedonisë, Kosovës dhe të Malit të Zi.

##### 1.2.1 Çështje të përgjithshme

Cilësia e ujit sipërfaqësor për rreth 80% të gjatësisë së lumenjve klasifikohet si e kënaqshme (kategori e klasit të parë) në përputhje me standardet e UNECE-s për Europën. Kjo është e kuptueshme nisur nga aktiviteti industrial shumë i kufizuar përgjatë këtyre lumenjve që mund të shkaktonte ndotjen e tyre.

Rezultatet e monitorimit të cilësisë së ujit gjatë periudhës 2006-2009 tregojnë një tendencë negative të cilësisë së ujit në disa lumenj që po dëmtohen shumë nga shkarkimet e ujërave të zeza nga familjet dhe bizneset. Nivelet e ndotjes organike janë rritur në mënyrë të konsiderueshme në

pellgun ujëmbledhës të lumit Ishëm (lumi i Lanës, Tiranë dhe i Ishmit), ndërkohë që treguesit e nitrogjenit dhe të fosforit janë brenda normave që konsiderohen të kënaqshme. Lumi Gjanicë që është degë e lumit Seman dhe që rrjedh nëpër qytetin e Fierit, po shfaq shenja të ndotjes së shtuar dhe po kthehet në një shqetësim.

Ligji nr.8093, datë 21.3.2006 “Për rezervat ujore” është ligji bazë që rregullon çështjet e menaxhimit të burimeve ujore në Shqipëri. Autoritetet kryesore të krijuara në bazë të këtij ligji janë Këshilli Kombëtar i Ujërave (KKU), Sekretariati Teknik i Këshillit Kombëtar të Ujërave (STKKU) dhe këshillat e baseneve të lumenjve. Këshilli Kombëtar i Ujërave kryesohet nga Kryeministri dhe është i ngarkuar me përcaktimin e politikave dhe me marrjen e vendimeve kryesore që lidhen me burimet ujore. Përveç Kryeministrit, në këshill bëjnë pjesë ministrinë kryesore të linjës ku përfshihen Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Brendshme, si dhe gjashtë prefekturat kryesore të baseneve përkatëse të lumenjve.

Në bazë të ligjit “Për rezervat ujore” dhe me qëllim për të përafuar direktivën europiane të ujit, në Ministrinë e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave është ngritur Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit të Ujërave që do të jetë organi kryesor për menaxhimin e burimeve ujore. Ministria e Mjedisit e propozoi këtë riorganizim të Sekretariatit Teknik të Këshillit Kombëtar të Ujërave, si strukturë qendrore përgjegjëse për zhvillimin dhe zbatimin e politikave kombëtare për menaxhimin e ujit dhe bashkërendimin sektorial, kombëtar dhe ndërkufitar.

Kjo drejtori e re do të luajë rolin e sekretariatit teknik përmes dy departamenteve, konkretisht Departamenti për Politikën e Ujit dhe Departamenti Teknik, që do të mbikëqyrin punën e gjashtë agjencive të baseneve të lumenjve.

Që në vitin 2002, janë krijuar në nivel vendor gjashtë (6) këshilla të baseneve të lumenjve për të menaxhuar burimet ujore në basenet përkatëse. Këshillat e Baseneve të Lumenjve janë përgjegjës për përgatitjen e planit të menaxhimit të burimeve ujore të basenit dhe për dokumentimin e inventarit të burimeve ujore, sa i përket sasisë dhe cilësisë. Këshillat e baseneve të lumenjve lëshojnë autorizime për nxjerrjen dhe përdorimin e ujit, si dhe shkarkimin e ujërave të zeza në mjedisin natyror. Këshillat e baseneve të lumenjve përbëhen nga zyrtarë të pushtetit qendror dhe vendor, ku një e treta përfaqësohet nga komuniteti i biznesit. Çdo këshill i baseneve të lumenjve kryesohet nga prefekti i qarkut në të cilin operon këshilli i basenit të lumit.

Sipas ligjit, është ngritur edhe Agjencia e Baseneve të Lumenjve (ABL) si agjenci ekzekutive e këshillave të baseneve të lumenjve. Aktualisht, Agjencia e Baseneve të Lumenjve (ABL) funksionon dhe është në procesin e forcimit të kapaciteteve dhe planifikimeve të hartimit të planeve të menaxhimit të baseneve ujëmbledhëse. Si rezultat i kësaj situatë, shpimi i puseve për ujë të pijshëm është pothuajse jashtë kontrollit në të gjithë Shqipërinë. Kjo praktikë e pakontrolluar mund të ketë ndikim të rëndë negativ mbi sasinë dhe cilësinë e ujërave nëntokësore në të ardhmen.

Nga pikëpamja e planifikimit dhe menaxhimit të baseneve të lumenjve, Shqipëria ka hartuar vetëm një plan formal për menaxhimin e basenit të lumit Mat.

Monitorimi i cilësisë së ujit në burimet sipërfaqësore është përgjegjësi e Institutit të Ujit, Energjisë dhe Mjedisit, ndërkohë që për ujërat nëntokësore përgjegjësinë e ka Shërbimi Gjeologjik Kombëtar.

Agjencia e Mjedisit dhe Pyjeve monitoron ndikimin e shkarkimeve të ujërave të zeza në ujërat sipërfaqësore (lumenjtë dhe zonat bregdetare), ndërkohë që Instituti i Shëndetit Publik nëpërmjet strukturave të veta rajonale monitoron higjienën dhe kushtet e tjera që lidhen me cilësinë e ujit.

#### 1.2.2 Çështjet prioritare që duhen adresuar në periudhën e planifikimit

- Hartimi dhe miratimi i një ligji të ri për rezervat ujore që të zëvendësojë ligjin nr.8093, datë 21.3.2006 “Për rezervat ujore”, me qëllim forcimin e rolit të Këshillit Kombëtar të Ujërave, rolit të këshillave të baseneve të lumenjve dhe rolit të agjencive të baseneve të lumenjve, si dhe përafrimin me direktivat e BE-së për ujërat, për sa i përket planifikimit dhe menaxhimit të baseneve të lumenjve.

- Forcimi dhe rritja e kapaciteteve të sekretariatit teknik, të këshillave të baseneve të lumenjve dhe të agjencive të baseneve të lumenjve për të realizuar plotësisht përgjegjësitë që u janë ngarkuar.

- Përgatitja e planeve të menaxhimit të baseneve të lumenjve për të gjashtë basenet e lumenjve në përputhje me direktivat e BE-së.

- Zbatimi i udhëzimit të Këshillit të Ministrave lidhur me zonat e mbrojtjes sanitare rreth grykave të puseve në fushat e puseve të nxjerrjes së ujit nëntokësor.

### 1.3 Performanca e ndërmarrjeve të ujësjellës-kanalizimeve

Spektori i ujësjellës-kanalizimeve në Shqipëri ka përfituar nga programi i institucionalizuar për monitorimin e treguesve të punës dhe vlerësimit krahasues, i ngritur pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Ujësjellës-Kanalizimeve në Ministrinë e Punëve Publike dhe Transportit. Ky program ka qenë plotësisht funksional gjatë 5 viteve të fundit. Njësia e Monitorimit të Treguesve të Punës dhe Vlerësimit Krahasues monitoron aktualisht 58 ndërmarrje të ujësjellës-kanalizimeve, 9 (nëntë) prej të cilave u shërbejnë vetëm zonave urbane, 6 (gjashtë) u shërbejnë vetëm zonave rurale dhe 43 (dyzet e tre) u shërbejnë njëkohësisht zonave urbane dhe rurale.

Treguesit e mëposhtëm të punës janë përzgjedhur nga një numër i madh treguesish të llogaritur nga Njësia e Monitorimit të Treguesve të Punës dhe Vlerësimit Krahasues, me qëllim që të sigurohet një panoramë e punës së ndërmarrjeve në sektor, dhe si bazë për objektivat prioritarë të shënjestruar që do të trajtohen në kuadër të strategjisë.

#### 1.3.1 Mbulimi me shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm

Mbulimi me shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm nënkupton rolin e ndërmarrjeve të ujësjellësit për t'i shërbyer popullsisë brenda zonave nën administrim, në shtrirje sa më të gjerë dhe me koston më efektive të mundshme. Analizat e kryera nga Njësia e Monitorimit të Treguesve të Punës dhe Vlerësimit Krahasues, tregojnë se popullsia e shërbyer nga ndërmarrjet e ujësjellësit në vitin 2010 arrinte në 2.65 milionë banorë, shifër kjo që përbën 80.3% të totalit të popullsisë në zonat që kanë nën administrim të gjitha ndërmarrjet e ujësjellësit (3.31 milionë banorë). Bazuar në të dhënat e siguruar, mbulimi me ujë të pijshëm është 90.7% në zonat urbane dhe 57.0% në zonat rurale.

Njësia e Monitorimit duhet të krijojë një instrument që mbledh të dhëna nga sistemet ujore që funksionojnë jashtë zonës së shërbimit të 58 ndërmarrjeve të ujësjellësit, si edhe nga sistemet e kanalizimeve që funksionojnë brenda zonës së shërbimit të ndërmarrjeve, por që nuk janë integruar në infrastrukturën ujësjellëse të ndërmarrjeve. Të gjitha këto të dhëna duhet të jenë pjesë e programit për raportimin e të dhënave.

#### 1.3.2 Mbulimi me shërbimin e kanalizimeve

Ashtu si mbulimi me shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, shërbimi i kanalizimeve përcaktohet si mbulimi me shërbim për popullsinë brenda zonës nën administrimin e ndërmarrjeve që e japin këtë shërbim. Njësia e Monitorimit të Treguesve të Punës dhe Vlerësimit Krahasues raporton se 1.65 milionë njerëz kanë qenë të lidhur me sistemin e kanalizimeve në vitin 2010, shifër e cila përfaqëson 64.6% mbulim me shërbim. Mbulimi me kanalizime ndahet: 83.0% në zonat urbane dhe 10.9% në zonat rurale.

Sipas Njesisë së Monitorimit të Treguesve të Punës dhe Vlerësimit Krahasues, shifra e mbulimit prej 83.0% në zonat urbane konsiderohet më e ulët se realja, pasi ekzistojnë zona urbane ku shërbimi me kanalizime kryhet nga njësitë e qeverisjes vendore si shërbim komunal, por këto njësi të qeverisjes vendore nuk janë pjesë e raportimit të të dhënave pranë Njesisë së Monitorimit të Treguesve të Punës dhe e Vlerësimit Krahasues. Në vitin 2010, shërbim kanalizimesh ofronin vetëm 30 nga 58 ndërmarrjet e ujësjellësit që raportojnë të dhëna pranë njesisë.

Është e nevojshme që Njësia e Monitorimit të zhvillojë dhe zbatojë mënyra/metodologji për mbledhjen e të dhënave nga njësitë e pushtetit vendor që operojnë sistemet e kanalizimeve brenda zonës së shërbimit të 30 shoqërive të furnizimit me ujë dhe kanalizime që raportojnë aktualisht te Njësia e Monitorimit dhe që nuk e sigurojnë këtë shërbim aktualisht.

### 1.3.3 Kërkesa për ujë të pijshëm

Prodhimi dhe shitja e ujit janë treguesit që përcaktojnë më së miri nevojat e prodhimit për të plotësuar kërkesën totale të popullsisë për furnizim me ujë të pijshëm. Për vitin 2010, Njësia e Monitorimit të Treguesve të Punës dhe e Vlerësimit Krahasues raportoi se prodhimi mesatar i ujit ishte 301 litra për frymë në ditë (292 milionë metra kub në vit) dhe shitja mesatare e ujit ishte 110 litra për frymë në ditë (107.5 milionë metra kub në vit). Diferenca mes këtyre dy shifrave tregon qartë masën e “ujit të pafaturuar” sipas kërkesës, dhe përfaqëson sasinë e ujit “që prodhohet, por nuk faturohet” për çdo person të furnizuar.

Shifrat e mësipërme tregojnë se uji i pafaturuar për vitin 2010 ishte 63.2%. Megjithatë, nuk duhet supozuar se 63.2% e ujit është ujë i humbur. Është fakt se shumë sisteme transmetimi dhe shpërndarjeje kanë një numër të konsiderueshëm lidhjesh “të paligjshme” apo “të paregjistruara”, që do të thotë se një pjesë e këtij 63.2%-shi përdoret dhe jep një shërbim të nevojshëm. Po kështu, vendosja e matësve mbetet shumë e ulët (44.6% e klientëve kanë matës dhe 46.3% e ujit të shitur është i matur); kjo do të thotë se nuk ka informacion të qartë në shkallë kombëtare për të arritur në një shifër reale të kërkesës.

Kapaciteti mesatar vjetor i burimeve të furnizimit me ujë në Shqipëri për vitin 2010 përllogaritej se ishte rreth 654 milionë metër kub në vit, ndërkohë që kërkesa totale për ujë, duke e vlerësuar me një normë prej 150 litrash për frymë në ditë (norma e kërkesës që aplikohet në Shqipëri) dhe një tolerancë prej 20% humbjeje teknike uji, është vlerësuar se ka qenë 197 milionë metra kub në vit për popullsinë e shërbyer dhe 240 milionë metra kub në vit për popullsinë në total në zonën e shërbimit. Kjo tregon se burimet totale në përdorim janë pothuaj sa 3-fishi i kërkesës së pritshme për të gjithë popullsinë, të shërbyer e të pashërbyer, në zonat nën administrimin e ndërmarrjeve. Kjo nuk do të thotë se të gjitha zonat kanë furnizim të bollshëm. Disa zona specifike kanë nevojë për investime në prodhimin e ujit për të plotësuar nevojat e kërkesës vendore. Këto shifra dëshmojnë që problemi në Shqipëri nuk është se duhet prodhuar më tepër ujë, por menaxhimi i kërkesës për ujin e prodhuar.

### 1.3.4 Vazhdimësia e shërbimit të furnizimit me ujë

Vazhdimësia e furnizimit me ujë lidhet me aftësinë e ndërmarrjes së ujësjellësit për të mbajtur rrjetin e shpërndarjes nën një presion të caktuar shërbimi, në mënyrë që t’u japë konsumatorëve të saj në mënyrë të vazhdueshme dhe pa ndërprerje. Njësia e Monitorimit të Treguesve të Punës dhe e Vlerësimit Krahasues raportoi një mesatare furnizimi të vazhdueshëm me ujë prej 11.1 orësh në ditë për sektorin në vitin 2010. Megjithëse ky tregues është përmirësuar me kalimin e kohës, ndërmarrjet e ujësjellësit akoma priren të mbiprodhojnë ujë me qëllim që të plotësojnë nevojat e popullsisë së cilës i shërbejnë, si dhe orët e furnizimit të përditshëm dhe presionin. Aktualisht, vetëm dy nga ndërmarrjet e ujësjellësit (Korça dhe Librazhdi) mund të ofrojnë ujë 24 orë me presion në të gjitha sistemet e tyre gjatë gjithë vitit. Në sisteme të tjera, popullsia e kompenson këtë mungesë të “vazhdimësisë së shërbimit” me anë të blerjes dhe të instalimit të pompave dhe të depozitave të ujit që mbushen kur sistemi i shpërndarjes është me presion. Faktorët kryesorë që shkaktojnë këtë vazhdimësi të ulët të furnizimit me ujë janë humbjet e ujit nga mbikonsumi i pamatur, si pasojë e faturimit afrofe, nga lidhjet e paligjshme dhe nga humbjet teknike në rrjete.

### 1.3.5 Siguria e furnizimit me ujë të pijshëm

Siguria e furnizimit me ujë të pijshëm ndikohet nga mbrojtja e burimeve që janë kryesisht puse dhe burime natyrore, dhe klorinimi i ujit në sistemet e shpërndarjes. Shqipëria ka ligje dhe rregullore që trajtojnë mbrojtjen e burimeve natyrore, si dhe mbrojtjen e grykave/fushave të puseve të ujit. Si rezultat i këtyre rregulloreve, nuk ka ndodhur asnjë ndotje në asnjë burim. Megjithatë, duhet që pushteti qendror, ndërmarrjet e ujësjellësve dhe pushteti vendor të jenë më agresivë në monitorimin rutinë dhe zbatimin e legjislationit në fuqi për mbrojtjen e zonave përreth burimeve me puse. Pushtetit vendor i takon të marrë masa ndaj kundërvajtësve, nisur nga kompetenca e tyre për të lëshuar leje ndërtimi.

Pavarësisht masave të sigurisë të zbatuara në burime, të gjitha ndërmarrjet e ujësjellësit aplikojnë klorinim të vazhdueshëm për të eliminuar ndotjen nga mikroorganizmat që mund të hyjnë



në sistemin e shpërndarjes. Siguria e furnizimit me ujë të pijshëm monitorohet nga Inspektorati Sanitar Shtetëror i Ministrisë së Shëndetësisë. Inspektorati Sanitar Shtetëror kryen analizat fiziko-kimike dhe ato bakteriologjike të ujit të pijshëm. Njësia e Monitorimit të Treguesve të Punës dhe e Vlerësimit Krahasues ka raportuar se në vitin 2010, respektimi i normave për klorinim ishte 96.9%, kurse për bakteret fekale koliform 98.8%. Njësia e monitorimit i merr të dhënat nga Inspektorati Sanitar Shtetëror, i cili ia dorëzon drejtpërdrejt.

#### 1.3.6 Trajtimi i ujërave të zeza

Aktualisht, Shqipëria ka dy impiante konvencionale mekanike të trajtimit të ujërave të zeza që ndodhen në Kavajë dhe në Pogradec; si edhe një impiant konvencional mekanik në Korçë, dhe tri, që janë kombinim i impianteve mekanike/ligatinave të ndërtruara për trajtimin e ujërave të zeza që ndodhen në Durrës, Sarandë dhe Lezhë, planifikuar për t'u vënë në funksionim deri në fund të vitit 2011. Së fundi, ekziston edhe një impiant konvencional mekanik i trajtimit të ujërave të zeza në Vlorë që është gati për funksionim, por që i mungon tubacioni kryesor që dërgon ujërat e zeza tek impianti; prandaj nuk është e qartë data se kur mund të fillojë punë ky impiant.

Këto impiante trajtimi të ujërave të zeza do të zotërohen, operohen dhe mirëmbahen nga ndërmarrjet e ujësjellës-kanalizimeve në zonat nën administrim. Është e qartë që duhen përpjekje të mëdha për t'i siguruar trajnim dhe forcim kapacitetesh personelit të kualifikuar, me qëllim që ndërmarrjet ta realizojnë me sukses këtë përgjegjësi të re.

Një parametër i matjes së mbulimit me shërbim kanalizimesh është numri i lidhjeve apo volumi i ujërave të zeza që përfundojnë te një impiant përpunimi, e shprehur në vlera numerike ose si përqindje e sasisë së prodhuar të ujërave të zeza në total. Gjatë vitit 2010, Njësia e Monitorimit të Treguesve të Punës dhe e Vlerësimit Krahasues nuk mblodhi të dhëna për matjen e mbulimit me këtë shërbim. Është raportuar se këto kërkesa shtesë dhe raporte të treguesve të punës janë përcaktuar nga Programi i Njesisë së Monitorimit të Treguesve të Punës dhe e Vlerësimit Krahasues dhe matje të tilla të punës do të jenë të disponueshme si të dhëna në vitin 2012.

#### 1.3.7 Gjykime lidhur me çështje të punës së ndërmarrjeve gjatë periudhës së planifikimit

Në kuadër të hartimit të strategjisë për sektorin, qeveria ka marrë në konsideratë çështjet e poshtëshënuara lidhur me punën aktuale të ndërmarrjeve që duhen trajtuar brenda periudhës së planifikimit:

- Mbulimi me shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm duhet të vazhdojë të rritet si përqindje e popullsisë që banon në zonat e shërbimit të ndërmarrjeve. Kjo vlen më shumë për zonat në periferi të zonave urbane dhe në zonat me vendbanime informale.

- Mbulimi me kanalizime për ujërat e zeza duhet të rritet, sidomos në zonat që janë më të urbanizuara dhe me dendësi popullore të lartë, ku ujërat e zeza në mjedisin natyror përbëjnë rrezik potencial për shëndetin publik.

- Menaxhimi i kërkesës për ujë duhet të jetë prioritet në të gjithë Shqipërinë, për të ulur kostot si pasojë e prodhimit të tepërt, i cili rezulton në ujë të pafaturuar; për të rritur volumin e ujit të shitur bazuar në konsumin e matur; për të arritur një shërbim furnizimi të vazhdueshëm me ujë për 24 orë dhe për të kontribuar në menaxhimin e qëndrueshëm financiar të ndërmarrjeve.

- Duhet instaluar sisteme të klorinimit me teknologji të avancuar në të gjitha sistemet e furnizimit me ujë të pijshëm në Shqipëri.

- Përqindja e ujërave të zeza që prodhohen dhe shkarkohen në kanalizime formale dhe që përfundojnë në një impiant të përshtatshëm përpunimi duhet të rritet, duhet monitoruar si matje e performancës dhe duhet rritur si përqindje.

#### 1.4 Aspektet rregullatore, institucionale dhe financiare të sektorit

Përveç aspekteve teknike dhe funksionale të ndërmarrjeve të ujësjellës-kanalizimeve, ekziston edhe një larmi aspektesh rregullatore, institucionale dhe financiare që janë po aq të rëndësishme për punën e suksesshme të ndërmarrjeve, aq më tepër në një mjedis tregtar që imponon vetëfinancim.

##### 1.4.1 Përmbledhje e kuadrit ligjor ekzistues për ujërat

Kuadri ligjor ekzistues synon të përmirësojë performancën e sektorit të ujërave duke siguruar bazën ligjore dhe rregullatore të sektorit. Aktualisht, 90% e aksioneve të ndërmarrjeve të

ujësjellësit u janë transferuar njësisive të qeverisjes vendore (NJQV-ve). Ministria e Punëve Publike dhe Transportit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjetllës-Kanalizimeve, kanë ushtruar rol mbështetës në procesin e decentralizimit të sektorit dhe janë të detyruara të përgatisin standarde të plota që ndihmojnë njësitë e qeverisjes vendore të ushtrorjnë funksionet e tyre.

Dispozita bazë ligjore për ndërmarrjet publike shtetërore është neni 213 i ligjit nr.9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”. Ndërmarrjet e ujësjellësit në Shqipëri konsiderohen “shoqëri aksionare” për sa i preket formës së tyre të organizimit, dhe rregullohen me ligjin nr.9901. Sipas “projektstatutit” të ndërmarrjeve të ujësjellësit të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave nr.678, datë 3.10.2007, veprimtaria ligjore e ndërmarrjeve aksionare të ujësjellës-kanalizimeve, përcaktohet si shërbimi i furnizimit me ujë të pijshëm të konsumatorëve dhe shitja e tij, prodhimi dhe/ose blerja e ujit për plotësimin e kërkesës së konsumatorëve, dhe mirëmbajtja e të dyja shërbimeve të furnizimit me ujë të pijshëm dhe të kanalizimeve.

Këshilli Mbikëqyrës është organi drejtues i shoqërive aksionare të ujësjellës-kanalizimeve, sipas statutit. Ai është i kufizuar në gjashtë anëtarë të zgjedhur nga Asambleja e Zakonshme e Aksionarëve. Mandati i anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës është tre vjet. Këshilli Mbikëqyrës raporton tek Asambleja e Aksionarëve lidhur me detyrimet e tij për mbikëqyrjen e përputhjes së veprimtarisë së shoqërisë me aktet ligjore në fuqi, si dhe me standardet dhe parimet e zbatueshme të kontabilitetit.

Në bazë të ligjit nr.8102, datë 28.3.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar me ligjin nr.9352, datë 3.3.2005 dhe ligjin nr.9915, datë 12.5.2008, Enti Rregullator i Ujit (ERRU) është organ i pavarur që ka të drejta ekzekutive për të vendosur tarifa dhe për të licencuar operatorë në sektorin e ujësjellësit.

#### 1.4.2 Decentralizimi i shërbimeve dhe transferimi i pronësisë të qeverisjes vendore

Ligji nr.8652, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” përcakton se NJQV-të janë përgjegjëse për ofrimin e shërbimit të furnizimit me ujë dhe të kanalizimeve në zonat e tyre përkatëse të shërbimit.

Aksionet dhe asetet e ndërmarrjeve të ujësjellësit iu transferuan NJQV-ve. Pronësia e aseteve të ndërmarrjeve të ujësjellësit duhet regjistruar kundrejt aksioneve të shoqërisë, të cilat zotërohen nga NJQV-të.

Enti Rregullator i Ujit i raporton Parlamentit dhe ka si funksione të pavarura përcaktimin e metodologjive tarifore për shërbimet e ujësjellës-kanalizimeve, lëshimin e licencave, politikat e subvencionimit dhe standardet e shërbimit konform burimeve financiare dhe kostos së shërbimit, cilësisë së ujit dhe ndikimit në mjedis të shërbimeve

#### 1.4.3 Aspekte financiare të sektorit

Këto shoqëri ekzistojnë për të dhënë shërbime furnizimi me ujë dhe kanalizimesh dhe janë shoqëri tregtare publike të një lloji të veçantë. Statusi dhe aktiviteti i tyre bazohet në ligjin nr.9901, datë 14.4.2008 dhe në aktet nënligjore në zbatim të tij.

Ndërmarrjet e ujësjellësit funksionojnë sipas një sistemi me dy nivele. Niveli menaxherial i ndërmarrjes merret me menaxhimin e përditshëm dhe me zbatimin e politikave e të programeve. Këshilli Mbikëqyrës është organi ekzekutiv i shoqërisë aksionare të ujësjellës-kanalizimeve sipas statutit; funksioni i përgjithshëm i Këshillit Mbikëqyrës është të mbikëqyrë funksionin ekzekutiv të shoqërisë dhe të garantojë mbrojtjen e interesave të aksionarëve.

Këshilli Mbikëqyrës mbikëqyr shoqërinë dhe verifikon performancën, me qëllim që të garantojë përputhshmërinë me dokumentin ekzekutiv, përgjegjshmërinë dhe përputhjen me ligjet dhe rregulloret, si dhe ruajtjen e mbikëqyrjes së duhur fiskale.

Këshilli Mbikëqyrës raporton tek Asambleja e Aksionarëve lidhur me detyrimet e tij për mbikëqyrjen e përputhjes së veprimtarisë së shoqërisë me aktet ligjore në fuqi, si dhe me standardet dhe parimet e zbatueshme të kontabilitetit. Lidhja e kontratave koncensionare me Agjencinë e Ujërave të Basenit, referuar akteve ligjore në fuqi, do sillte ndryshime në vlerën e kostove aktuale në ndërmarrje dhe do të shoqërohej me rritjen e efikasitetit ekonomik të përdorimit të ujit nga ky sektor, në kontekstin global.

Shumica e ndërmarrjeve të ujësjellësit nuk janë në gjendje të mbulojnë kostot operative, si pasojë e disa faktorëve: tarifat e ulëta, arkëtimi i ulët i faturave, niveli i lartë i ujit të pafaturuar dhe eficaenca e përgjithshme e mangët. Për vitin 2010, kostoja operative mesatare për metër kub ujë të shitur ishte 42.9 lekë, ndërkohë që çmimi mesatar për metër kub ujë të shitur ishte 38.2 lekë, pra një humbje operative prej 4.7 lekësh për metër kub ujë të shitur.

Mbulimi mesatar i kostos totale, bazuar në të ardhurat (shumat e faturuara) është në nivelin e 66.6%, ndërsa në bazë të arkëtimeve faktike aktuale, mbulimi i kostos totale është 56.1%.

Kostoja totale e ndërmarrjeve të ujësjellësit në vitin 2010 ka këtë përbërje: 29.4% është kosto energjie, 30.6% është kosto personeli dhe sigurimesh shoqërore, 20.6% është kosto amortizimi dhe 19.4% janë kosto të tjera ku futen kimikatet, mirëmbajtja, riparimet etj. Kostot e larta të personelit pasqyrohen edhe nga treguesi i numrit të punonjësve për 1 000 lidhje, që është në nivelin e 5.5 punonjësve për 1 000 lidhje.

Ndërmarrjet e ujësjellësit marrin subvencione në bazë të udhëzimit nr.6569, datë 27.6.2006, i nxjerrë së bashku nga Ministria e Punëve Publike dhe Transportit dhe Ministria e Financave “Për kriteret e procedurat për përdorimin e subvencioneve shtetërore për sh.a. dhe ndërmarrjet e ujësjellës-kanalizimeve”, në baza vjetore për të mbuluar kostot e energjisë dhe të kontributeve të sigurimeve shoqërore. Politika e qeverisë ka synuar të reduktojë shumën e subvencioneve gjatë katër viteve të fundit. Në kuadrin e reformës së decentralizimit të sektorit, është planifikuar që subvencionet të hiqen në të ardhmen e afërt.

Pushteti qendror ka si rol primar kanalizimin e fondeve të donatorëve dhe të thesarit për të realizuar përmirësime kapitale, bazuar në vlerësimin e nevojave të shprehur nga pushteti vendor dhe në kushtet e përgjithshme të shërbimit për publikun. Gjithashtu, pushteti qendror ofron garanci për huat që institucionet financiare ndërkombëtare japin për ndërmarrje ujësjellësi të caktuara, dhe aktualisht u jep subvencione operationale pushtetit vendor që të financojnë ndërmarrjet e tyre të ujësjellës-kanalizimeve.

#### 1.4.4 Kontabilizimi i kostos dhe vendosja e tarifave

Menaxhimi i aseteve dhe qëndrueshmëria lidhen me kontabilizimin e plotë të kostos. Vihet re një mungesë e theksuar dokumentacioni për asetet e sistemeve të ujësjellës-kanalizimeve.

Programi i menaxhimit të aseteve do të siguronte informacionin e nevojshëm për të kaluar në një program kontabilizimi të plotë të kostos, si edhe për të integruar planifikimin e zgjerimit të kapaciteteve me zëvendësimin e infrastrukturës. Regjistrat e aseteve të ndërmarrjeve të ujësjellësit nuk përditësohen periodikisht për të përfshirë, si inventarin vjetor të aseteve edhe certifikimin e Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.

Mbajtja artificiale e tarifave të ulëta për klientët aktualisht rezulton nën një rreth vicioz që konsiston nga ofruet shërbimi me financim të dobët, investime të pamjaftueshme dhe përkeqësim të infrastrukturës e të shërbimeve, çka pakëson përfitimet e përdoruesve e rrjedhimisht edhe gatishmërinë e tyre për të paguar. Tarifat e ulëta pengojnë zgjerimin e rrjeteve drejt komuniteteve më të varfra, të cilat detyrohen të gjejnë mënyra alternative furnizimi, ku përfshihen lidhjet e paligjshme dhe pushtet e cekëta me cilësi shumë të ulët uji.

#### 1.4.5 Arkëtimet, tendencat dhe alternativat e zbatimit të ligjit

Nivelet aktuale të çmimit të ujit nuk mbulojnë të gjitha kostot dhe niveli i arkëtimeve vazhdon të mos jetë i kënaqshëm. Niveli i përgjithshëm i arkëtimeve për vitin 2010 ishte 84.2%, me rritje pozitive krahasuar me vitet e kaluara. Konsumatorët familjarë që përbëjnë kategorinë më të madhe të konsumatorëve të sektorit, kanë përqindjen më të ulët të arkëtimeve në krahasim me kategoritë e tjera. Përqindja e arkëtimeve të konsumit familjar është 70%, ndërsa i konsumit të subjekteve private është 83%.

Megjithëse ligji nr.8975, datë 21.11.2002, përcakton se fatura e ujit është “titull ekzekutiv”, moszbatimi i ligjit nga konsumatorët që nuk paguajnë faturat dhe përhapja e gjerë e lidhjeve të paligjshme ka bërë që ndërmarrjet e ujësjellësit të jenë në situatë të vështirë financiare të ndërmarrjeve të ujësjellësit.

Për të përmirësuar arkëtimet, ndërmarrjet duhet të përdorin sisteme kompjuterike për faturimin dhe kontabilizim të kostos, të zbatojnë procedura për ndjekjen e debitorëve, të organizojnë fushata edukimi publik dhe të përmirësojnë shërbimin ndaj klientit.

#### 1.4.6 Kompetencat aktuale të entit rregullator

Enti Rregullator i Ujit (ERRU), nën vartësinë e Komisionit Kombëtar të Rregullimit, funksionon brenda kuadrit ligjor dhe në përputhje me ligjin nr.8102, datë 28.3.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar me ligjin nr.9352, datë 3.3.2005 dhe ligjin nr.9915, datë 12.5.2008. Aktiviteti i Komisionit mbështetet në parimet e pavarësisë, profesionalizmit, transparencës dhe ligjshmërisë, për të garantuar dhe mbrojtur interesat publike dhe për të vendosur ekuilibrin e duhur ndërmjet interesave të konsumatorëve, qeverisë, publikut, investitorëve dhe pjesëmarrësve në sektorin e ujësjellës-kanalizimeve.

Kompetencat aktuale të komisionit të Entit Rregullator të Ujit përfshijnë licencimin, vendosjen e çmimeve dhe tarifave, vendosjen e standardeve për programet e investimeve dhe shitjen e aseteve, raportimin në Këshillin e Ministrave për gjendjen e sektorit, vendosjen e penaliteteve monetare dhe administrative ndaj subjekteve tregtare që operojnë në sektorin e shërbimit të furnizimit me ujë, edhe kur sistemet e ujësjellës-kanalizimeve janë transferuar në pronësi të njëjësive të qeverisjes vendore.

Enti Rregullator i Ujit (ERRU) është i vetmi autoritet në Republikën e Shqipërisë që lëshon licenca për çdo person fizik dhe juridik që operon brenda sektorit të shërbimeve të ujësjellës-kanalizimeve, Edhe pse është e detyrueshme me ligj, jo të gjitha ndërmarrjet e ujësjellësit janë të licencuara, ndërkohë që nuk është licencuar asnjë sistem ujësjellësi i komunave.

ERRU-ja ka përgatitur një sërë metodologjish për të vendosur tarifa për mbulimin e kostos, për operatorët e licencuar që të kryejnë aktivitetet në sektorin e ujit.

#### 1.4.7 Gjykime lidhur me çështjet rregullatore, institucionale dhe financiare gjatë periudhës së planifikimit

Në kuadër të hartimit të strategjisë për sektorin, qeveria ka marrë në konsideratë çështjet e poshtëshënuara, lidhur me kushtet ekzistuese rregullatore, institucionale dhe financiare që duhen trajtuar brenda periudhës së planifikimit:

- Nevojitet forcim i vazhdueshëm i Entit Rregullator të Ujit për të garantuar që personeli i tij është i përgatitur për të ushtruar në mënyrë profesionale dhe të imët kompetencat dhe përgjegjësitë që janë përcaktuar në legjislacionin në fuqi.

- Zgjerim i veprimtarive zbatuese të Entit Rregullator të Ujit në lidhje me kompetencat e tij për të lëshuar licenca për ofrimin e shërbimit të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve për publikun, me qëllimin që të licencohen të gjitha subjektet publike dhe private të angazhuara në këtë veprimtari.

- Vendosja dhe rishikimi i tarifave duhet të jetë një proces me synimin për të mbuluar plotësisht koston me të ardhurat e ndërmarrjes, ku të përfshihet: shlyerja e borxheve, pagimi i interesave të borxheve dhe financimi i rezervave për të mbuluar amortizimin e të gjitha aseteve.

- Forcimi i Drejtorisë së Përgjithshme të Administrimit të Ujërave, në mënyrë të tillë që të kryejë detyrat e Sekretariatit Teknik të Këshillit Kombëtar të Ujërave, si edhe forcimi i agjencive të baseneve të lumenjve për t'i bërë të afta të përmbushin funksionet e tyre në zbatim me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e aksesit dhe nxjerrjes së ujit nga mjedisi natyror. Ai duhet ta realizojë këtë nëpërmjet ushtrimit të kompetencave të tij për lëshimin e lejeve dhe duke zbatuar në mënyrë të qëndrueshme një pagesë për nxjerrje të tilla, bazuar mbi volumin, me qëllimin që agjencitë e baseneve lumore të bëhen financiarisht të vetëqëndrueshme.

- Zbatimi i vendimit të qeverisë për të shkuar drejt bashkimit të ndërmarrjeve të ujësjellësit në një numër të vogël ofruesish shërbimesh por më të mëdhenj në përmasa, duke aplikuar konceptin e vendimmarrjes vullnetare në nivel pushteti vendor, e shoqëruar me stimuj ekonomikë nga pushteti qendror për të nxitur bashkimin, si mjet për realizimin e ekonomive të shkallës, rritjen e efikasitetit dhe rendimentit të stafit, të cilët janë tipike për sektorin e ujësjellës-kanalizimeve.

- Mbështetje për hartimin e legjislacionit dhe miratimin nga Kuvendi, për të siguruar përafrim të plotë të legjislacionit të brendshëm me direktivat e BE-së për ujërat, dhe duke futur konceptin “përdoruesi paguan” për shërbimet e furnizimit me ujë dhe kanalizimet.

### 1.5 Pjesëmarrja e sektorit privat në sektorin e ujësjellës-kanalizimeve

Pjesëmarrja e sektorit privat përfshin kontratën ndërmjet autoritetit të sektorit publik dhe operatorit të sektorit privat, ku operatori privat siguron një shërbim publik nëpërmjet një kontrate, dhe ndërmerr një numër rreziqesh financiare, tregtare, teknike dhe operacionale në kuadër të dhënies së këtij shërbimi, bazuar në termat e kontratës. Pjesëmarrja e sektorit privat shpesh reklamohet si rrugëzgjdhje për shërbime publike efikase dhe financiarisht të qëndrueshme në veprimtari normalisht publike të tilla si: uji, energjia, transporti, shëndetësia, arsimiti etj. Për mbi dy dekada tashmë, është besuar gjerësisht se pjesëmarrja e sektorit privat përbën një nga zgjidhjet më të mira për të sjellë përmirësime në dhënien e shërbimeve publike, për sa i përket investimeve, efikasitetit, dhënies së shërbimit, përgjegjshmërisë etj.

Pjesëmarrja e sektorit privat në sektorin e ujësjellës-kanalizimeve është diçka krejt e re në vendet në zhvillim si Shqipëria. Qeveria është e vendosur të përmirësojë shërbimet e ujësjellës-kanalizimeve dhe të reduktojë barrën financiare që duhet të mbajë duke mbështetur sektorin e ujit, prandaj ka ndërmarrë reforma gjithëpërfshirëse në sektorin e ujësjellësit. Pjesëmarrja e sektorit privat përbën një element kyç të këtyre reformave. Është kuptuar qartë se pjesëmarrja e sektorit privat sjell një përfaqje më komerciale në ofrimin e infrastrukturës dhe reduktimin e ndërhyrjeve politike. Pushteti qendror e mbështet konceptin e pjesëmarrjes së sektorit privat në sektorin e shërbimeve të ujësjellës-kanalizimeve, meqë kështu ekziston një opsion konkurrues në një sektor monopolist nga natyra.

Gjithashtu, pushteti qendror është i vetëdijshëm për risqet që mbart pjesëmarrja e parakohshme e sektorit privat në një situatë specifike, si edhe në kushtet kur mungon aftësia për identifikimin e riskut dhe as aftësia për të mbikëqyrur performancën dhe respektimin e kushteve dhe termave të kontratave.

#### 1.5.1 Kuadri rregullator për pjesëmarrjen e sektorit privat

Kuadri ligjor në lidhje me pjesëmarrjen e sektorit privat është i mjaftueshëm krahasuar me standardet ndërkombëtare. Investimet e huaja janë plotësisht të mbrojtura me ligj.

- Ligji nr.8093, datë 21.3.1996 “Për rezervat ujore” që trajton saktë të gjitha problemet e përdorimit të ujërave, sipas llojeve të aktiviteteve.

- Ligji nr.7973, datë 26.7.1995 “Për koncesionet dhe pjesëmarrjen e sektorit privat në shërbimet publike dhe infrastrukturë” krijoi kuadrin ligjor për pjesëmarrjen e sektorit privat në dhënien e shërbimeve publike.

- Ligji nr.8306, datë 14.3.1998 “Për strategjinë e privatizimit të sektorëve me rëndësi të veçantë” parashikoi strategjinë për privatizimin e sektorëve të deklaruar si të rëndësishëm të veçantë (që përfshin edhe sektorin e ujësjellësit).

- Ligji nr.9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”. Qëllimi i këtij ligji është të krijojë kuadrin e nevojshëm për nxitjen dhe lehtësimin e zbatimit të koncesioneve me financim privat, me objektivin për të rritur transparencën, drejtësinë, efikasitetin dhe qëndrueshmërinë afatgjatë në zhvillimin e infrastrukturës dhe të projekteve të shërbimit publik. Ky ligj përcakton procedurat e veçanta për dhënien e projekteve të koncesionit. Ky ligj zbatohet për dhënien e koncesioneve nga autoritetet kontraktuese (ministra ose pushteti vendor) për veprimtaritë ekonomike në disa sektorë strategjikë duke përfshirë prodhimin, shpërndarjen dhe trajtimin e ujit, grumbullimin, dërgimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura, vaditjen, kullimin, digat etj.

#### 1.5.2 Përvoja e pjesëmarrjes së sektorit privat në të shkuarën në Shqipëri

Kanë ekzistuar disa përvoja lidhur me futjen e pjesëmarrjes së sektorit privat në sektorin e ujit në Shqipëri. Me asistencën e donatorëve ndërkombëtarë, janë zbatuar tri kontrata për pjesëmarrjen e sektorit privat, konkretisht:

##### a) Koncesioni i Elbasanit

Shembulli i parë i kontratës me pjesëmarrje të sektorit privat në sektorin e ujit në Shqipëri ka qenë kontrata e koncesionit që iu dha Berlinwasser International (BEI) në vitin 2002 për ish-Ndërmarrjen Shtetërore të Ujësjellës-Kanalizimeve që i shërbente qytetit të Elbasanit. Tenderi u realizua në bazë të propozimeve të pakërkuara, dhe projektin e financoi “Kreditanstalt für Wiederaufbau (KfW)”. Koncesioni i Elbasanit rezultoi në një përvojë të përzier, e cila zgjati vetëm

5 vjet nga 30 vjet që kishte kontrata e koncesionit. Ka argumente të shumëllojshme lidhur me vështirësitë me të cilat u përball koncesionari që e çuan në humbje të mëdha financiare. Për të shmangur humbjet e mëtejshme, koncesionari ia shiti shoqërinë e projektit “ELBER”, Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës. Pavarësisht dështimit financiar, shoqëria e projektit ELBER solli disa përmirësime në funksionimin e ndërmarrjes: rriti orët e furnizimit, rriti arkëtimet dhe uli konsumin e energjisë.

b) Kontratat e menaxhimit me “katër bashkitë”

Kjo kontratë menaxhimi bashkoi katër ndërmarrje ujësjellësi nën një kontratë të vetme (Durrës, Fier, Lezhë, Sarandë). Ajo u zbatua me mbështetjen financiare të Bankës Botërore, e cila këshilloi qeverinë shqiptare të përdorte kontratë menaxhimi bazuar në performancë, si forma më e përshtatshme për të tërhequr operatorë privatë në përmirësimin e shërbimeve dhe të performancës së katër ndërmarrjeve të ujësjellësit.

Kontrata e menaxhimit “katër bashkitë” që përfundoi në fund të gushtit 2008, është konsideruar relativisht e suksesshme. Treguesit e performancës së katër ndërmarrjeve të ujësjellësit treguan përmirësime në cilësinë e shërbimit dhe në performancën e tyre operacionale e financiare, në krahasim me kohën kur ishin nën menaxhimin e operatorit publik. Megjithatë, kontrata nuk sollti nivelet e pritshme të shërbimit dhe të qëndrueshmërisë financiare të ndërmarrjeve. Gjithashtu, kontrata nuk përmbushi pritshmërinë e njësive të qeverisjes vendore.

c) Kontrata e menaxhimit të Kavajës

Në qershor 2003, një operator privat u shpall fitues i një kontrate menaxhimi për ndërmarrjen e ujësjellës-kanalizimeve që i shërbente bashkisë së Kavajës dhe komunave përreth. Kjo kontratë e financuar nga KfW kishte afat 3-vjeçar me mundësi zgjatjeje për një vit. Objektivi i kësaj kontrate menaxhimi ishte të përmirësonte menaxhimin dhe funksionimin, pa financime shtesë për investime kapitale. Prandaj, huaja e dhënë nga KfW ishte e kufizuar të menaxhimi i tarifave dhe nxitja e pagesave, dhe nuk parashikonte fonde për financimin e investimeve kapitale. Kontrata përmirësoi funksionimin e ndërmarrjes së ujësjellësit, por nuk përmbushi objektivat e përcaktuar në kontratë.

1.5.3 Gjykime lidhur me PSP-në gjatë periudhës së planifikimit

Ekzistojnë disa mënyra, në të cilat qeveria mund të mbështesë pjesëmarrjen e sektorit privat për të maksimizuar përfitimet. Mbështetja që qeveria mund të japë përfshin:

- Mbështetje për procese dhe dokumentacion cilësor për transaksionet. Kontratat dhe transaksionet e pjesëmarrjes së sektorit privat janë komplekse. Këshilltarët me përvojë të pjesëmarrjes së sektorit privat e kuptojnë se si funksionojnë kontratat e pjesëmarrjes së sektorit privat dhe e dinë ç’gabime janë bërë në të kaluarën. Mbajtja e këshilltarëve me përvojë për hartimin e kontratave dhe zbatimin e transaksioneve minimizon problemet që mund të lindin më vonë me kontratat.

- Akses në financime. Qeveria mund t’i ndihmojë bashkitë të diskutojnë nevojat e tyre me donatorët dhe të ofrojë kanalet e përshtatshme për fonde kapitale.

- Subvencionim tarifash për kategoritë me të ardhura të ulëta. Shumica e bashkive nuk do të kenë fonde të mjaftueshme për subvencionimet, kështu që do t’i kërkojnë qeverisë fonde subvencionimi.

- Duke ndihmuar bashkitë fqinje të arrijnë sinergji përmes rajonalizimit. Shumica e bashkive janë të vogla dhe do të përfitonin nga bashkëpunimi. Qeveria mund t’u japë këshillat e përshtatshme, si krijimi i një ndërmarrjeje rajonale me burime ujore të përbashkëta, të ofrojë asistencë teknike dhe të lehtësojë këtë proces.

- Duke i ofruar pushtetit vendor mbështetje rregullatore dhe mbështetje për menaxhimin e kontratave. Meqë kontratat janë komplekse, pushteti vendor mund të mos ketë kapacitetet e duhura teknike për të monitoruar performancën e kontratës. Prandaj, qeveria mund të ofrojë ndonjë formë asistencë të centralizuar të gjitha njësive të qeverisë vendore, pasi kjo ka edhe kosto më të ulët sesa të lihen bashkitë ta bëjnë këtë vetë.

## KAPITULLI 2 VIZIONI, MISIONI DHE OBJEKTIVAT PRIORITARË

Kjo strategji e sektorit të ujësjellës-kanalizimeve është e veçantë sepse është përgatitur me kontributin e gjerë dhe drejtimin e një Grupi Këshillimor ndërministror dhe ka pasur privilegjin e të dhënave cilësore për sektorin, të siguruar nga Njësia e Monitorimit të Treguesve të Punës dhe e Vlerësimit Krahasues që ka funksionuar me efektshmëri nën varësinë e Drejtorisë së Përgjithshme të Ujësjellës-Kanalizimeve për mbi pesë vjet. Ky kontribut i gjerë i aktorëve i kombinuar me të dhënat statistikore në funksion të vendimmarrjes për prioritetet dhe planet e veprimit, e veçon këtë strategji nga strategjitë e tjera të hartuara në të kaluarën.

### 2.1 Vizioni

Vizioni i kësaj strategjie sektoriale për periudhën 2011-2017 reflekton situatën aktuale të Shqipërisë në lidhje me rritjen e investimeve të përgjithshme në sektorin e ujësjellës-kanalizimeve, në mënyrë që në fund të kësaj periudhe planifikimi të jetë arritur përmirësim i dukshëm në nivelin dhe cilësinë e shërbimeve, i perceptuar nga përdoruesi final. Vizioni i kësaj strategjie sektoriale paraqitet si më poshtë:

#### Vizioni

Hartimi i politikave të përshtatshme dhe angazhimi i fondeve të mjaftueshme për të përmirësuar dhënien e shërbimeve të ujësjellësit dhe të kanalizimeve, dhe për të ecur në mënyrë të qëndrueshme drejt përputhjes me standardet e Bashkimit Europian dhe me objektivin e zhvillimit të mijëvjeçarit për qëndrueshmërinë e mjedisit.

Siç thuhet edhe në hyrjen e strategjisë, Qeveria Shqiptare si bashkësponsorizuese e Rezolutës së Kombeve të Bashkuara për ta bërë “aksesin në ujë të pijshëm të sigurt dhe kanalizime të drejta të njeriut”, është e angazhuar të garantojë cilësinë për të gjithë qytetarët, për sa i përket të drejtave të njeriut për ujin e pijshëm dhe kanalizimet.

Qeveria Shqiptare është realiste në aspiratat e veta se kur mund t’i përmbushë përfundimisht standardet e BE-së për këtë sektor, ndaj pranon nëpërmjet kësaj deklarate se nuk do të arrihen brenda kësaj periudhe planifikimi shtatëvjeçar. Megjithatë, qeveria e konsideron qëllim pajtueshmërinë me standardet e BE-së, dhe do t’i drejtojë të gjitha burimet e angazhuara për këtë sektor për arritjen e këtij qëllimi.

### 2.2 Objektivat e misionit

Misioni i kësaj strategjie sektoriale shërben për të fokusuar iniciativat e qeverisë në pesë objektiva, që duhen adresuar si në politikë ashtu dhe në terren, me qëllim përmirësimin e dëshiruar të shërbimeve të ujësjellës-kanalizimeve. Objektivat e misionit të kësaj strategjia sektoriale janë si vijon:

#### Objektivat e misionit:

- Zgjerimi dhe përmirësimi i cilësisë së shërbimeve të sektorit të ujësjellës-kanalizimeve.
- Orientimi i shërbimeve të ujit drejt parimeve të kontrollit dhe rikuperimit të plotë të kostove.
- Përmirësimi i drejtimit dhe rregullimit të sektorit.
- Investime për rritjen e kapaciteteve të fuqisë punëtore të sektorit.
- Progresi drejt harmonizimit të legjislacionit të brendshëm me direktivat e BE-së për ujin.

### 2.3 Ndërhyrjet në kuadër të objektivave të misionit

Objektivat e misionit të përmendur më lart mund të identifikohen me një sërë masash që duhen zbatuar për të përmbushur secilin objektiv. Këto masa janë paraqitur më poshtë sipas lidhjes me objektivat e misionit.

#### 2.3.1 Zgjerim dhe përmirësim i cilësisë së shërbimeve të sektorit të ujësjellës-kanalizimeve

- Rritja e aksesit të popullsisë urbane dhe rurale në furnizimin me ujë të pijshëm të sigurt.
- Rritja e lidhjeve të popullsisë urbane dhe rurale me rrjetet e grumbullimit të ujërave të zeza.

- Shtim i orëve të shërbimit për popullsinë urbane dhe rurale.
- Rritja e përqindjes së popullsisë të lidhur me rrjetin e grumbullimit të ujërave të zeza, i cili është i lidhur me një impiant përpunimi.

- Hartimi dhe realizimi periodik i vrojtimit të nevojave kombëtare për të përcaktuar projektet prioritare për investime.

2.3.2 Orientimi i shërbimeve, të ujit drejt parimeve të kontrollit dhe rikuperimit të plotë të kostove

- Orientimi i shërbimeve në mënyrë të tillë që të rikuperohen plotësisht kostot operacionale dhe të mirëmbajtjes, shlyerja e borxhit, dhe shpenzimet kapitale për riparime dhe zëvendësime.

- Fokusimi i investimeve në reduktimin e konsumimit të ujit dhe energjisë që nuk gjeneron të ardhura.

- Krijimi i një programi, sipas së cilit të gjitha shërbimet e licencuara të ujit duhet të kenë një sistem menaxhimi asetesh plotësisht të dokumentuar.

- Të gjitha shërbimet e licencuara të ujit duhet të zhvillojnë dhe të përditësojnë vit pas viti një plan biznesi pesëvjeçar.

- Zhvillimi dhe zbatimi i një programi subvencionimi për familjet e varfra.

2.3.3 Përmirësim i drejtimit dhe rregullimit të sektorit

- Forcimi i mëtejshëm i rolit të Entit Rregullator të Ujit.

- Zgjerim i aktiviteteve licencuese të Entit Rregullator të Ujit, me synim licencimin e të gjitha sistemeve të ujësjellës-kanalizimeve.

- Hartimi dhe përhapja e një kontrate tip për dhënien e shërbimeve, që të negociohet ndërmjet ndërmarrjeve të ujësjellës-kanalizimeve dhe njësive të qeverisjes vendore.

- Forcimi i Drejtorisë së Përgjithshme të Administrimit të Ujërave në rolin e vet si sekretariat teknik nën varësinë e Këshillit Kombëtar të Ujërave, si dhe i mbikëqyrjes së agjencive të baseneve të lumenjve.

2.3.4 Investime për rritjen e kapaciteteve të fuqisë punëtore të sektorit

- Hartimi i një programi kombëtar trajnimi dhe certifikimi, sipas kërkesave për trajnim të të gjitha shërbimeve të ujit.

- Të gjithë anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës të shërbimeve të licencuara të ujit t'u kërkohet të marrin pjesë dhe të përfundojnë trajnimin për rolet, detyrat, autoritetet dhe përgjegjësitë e tyre.

2.3.5 Progresi drejt harmonizimit të legjislacionit të brendshëm me direktivat e BE-së për ujin

- T'i propozohet Parlamentit legjislacion për ujin që është i harmonizuar me direktivat e BE-së për ujin.

- Hartimi i një ligji të ri specifik për shërbimet e ujësjellës-kanalizimeve.

- Fillimi i një programi që inkurajon bashkimin e ndërmarrjeve të ujësjellësit.

- Vizioni dhe objektivat e misionit, si dhe masat prioritare nën secilin objektiv paraqiten grafikisht në figurën 2-1. Këto masa prioritare do të përcaktohen më qartë në nënparagrafin 2.4 të këtij kapitulli të strategjisë, si objektiva strategjike specifike, të matshëm dhe me afat kohor.



Figura 2-1 VIZIONI – OBJEKTIVAT E MISIONIT – TABELA E MASAVE

VIZIONI		Hartimi i politikave të përshtatshme dhe angazhimi i fondeve të mjaftueshme për të përmirësuar dhënien e shërbimeve të ujësjellësit dhe kanalizimeve, dhe për të ecur në mënyrë të qëndrueshme drejt përputhjes me standardet e Bashkimit European dhe me objektivin e zhvillimit të mijëvjeçarit për qëndrueshmërinë e mjedisit				
OBJEKTIVAT E MISIONIT	1. Zgjerimi dhe përmirësimi i cilësisë së shërbimeve të ujësjellës-kanalizimeve	2. Orientimi i ndërmarrjeve të ujësjellësit drejt parimeve të kontrollit dhe rikuperimit të plotë të kostos	3. Përmirësimi i drejtimit dhe rregullimit të sektorit	4. Investime për rritjen e kapaciteteve të fuqisë punëtore të sektorit	5. Progresi drejt harmonizimit të legjislacionit të brendshëm me direktivat e BE-së	
<b>M A S A T P R I O R I T A R E</b>	1.a Rritja e aksesit të popullsisë urbane dhe rurale në furnizimin me ujë të pijshëm të sigurt	2.a Orientimi i shërbimeve, në mënyrë të tillë që të rikuperohen plotësisht kostot operacionale dhe të mirëmbajtjes, shlyerja e borxhit, dhe shpenzimet kapitale për riparime dhe zëvendësime	3.a Forcimi i mëtejshëm i rolit të Entit Rregullator të Ujit	4.a Hartimi i një programi kombëtar trajnimi dhe certifikimi, sipas kërkesave për trajnim të të gjitha shërbimeve të ujit	5.a T'i propozohet parlamentit legjislacion për ujin që është i harmonizuar me direktivat e BE-së për ujin	
	1.b Rritja e lidhjeve të popullsisë urbane dhe rurale me rrjetet e grumbullimit të ujërave të zeza	2.b Fokusimi i investimeve në reduktimin e konsumimit të ujit dhe energjisë që nuk gjeneron të ardhura	3.b Zgjerim i aktiviteteve licencuese të Entit Rregullator të Ujit me synim licencimin e të gjitha sistemeve të ujësjellës-kanalizimeve	4.b Të gjithë anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës të shërbimeve të licencuara të ujit t'u kërkohet të marrin pjesë dhe të përfundojnë trajnimin për rolet, detyrat, autoritetet dhe përgjegjësitë e tyre	5.b Hartimi i një ligji të ri specifik për shërbimet e ujësjellës-kanalizimeve	
	1.c Shtim i orëve të shërbimit për popullsinë urbane dhe rurale	2.c Krijimi i një programi, sipas të cilit të gjitha shërbimet e licencuara të ujit duhet të kenë një sistem menaxhimi asetesh plotësisht të dokumentuar	3.c Hartimi, përhapja e një kontrate tip për dhënien e shërbimeve	3.d Forcimi i Drejtorisë së Përgjithshme të Administrimit të Ujërave në rolin e vet si sekretariat teknik nën varësinë e këshillit kombëtar të ujërave, si dhe i mbikëqyrjes së agjencive të baseneve të lumenjve	5.c Fillimi i një programi që inkurajon bashkimin e ndërmarrjeve të ujësjellësit	
	1.d Rritja e përqindjes së popullsisë së lidhur me rrjetin e grumbullimit të ujërave të zeza, i lidhur me një impiant përpunimi	2.d Të gjitha shërbimet e licencuara të ujit duhet të zhvillojnë dhe të përditësojnë vit pas viti një plan biznesi pesëvjeçar				
	1.e Hartimi dhe realizimi periodik i vërtetimit të nevojave kombëtare për të përcaktuar projektet prioritare për investime	2.e Zhvillimi dhe zbatimi i një programi subvencionimi për familjet e varfra				

## 2.4 Qëllimet strategjike në mbështetje të objektivave prioritarë për sektorin

Synimi i Qeverisë Shqiptare ishte të përgatitej një strategji për sektorin e shërbimit të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve, që të kishte gjuhë të shkurtër në gjuhë, qëllime strategjike specifike, të ishte e matshme, me afate kohore për ndërhyrjet dhe e përgjegjshme, për sa i përket përgjegjësisë institucionale.

Metoda e përdorur për të realizuar synimin e shprehur ishte përcaktimi i pesë objektivave të misionit, në dritën e secilës çështje prioritarë, duke konvertuar çështjet prioritarë në qëllime strategjike të matshme me tregues performance, në mënyrë që të monitorohen gjerësisht nga programi për monitorimin e treguesve të punës dhe vlerësimit krahasues në Drejtorinë e Përgjithshme të Ujësjellës-Kanalizimeve në varësi të Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit.

Këto qëllime strategjike janë specifike, të matshme dhe me afate kohore, dhe janë gjykuar nga grupi i punës së strategjisë të realizueshme brenda këtyre afateve.

Tabela 2-1 paraqet qëllimet strategjike dhe treguesit e parashikuar të performancës për secilin prioritet, së bashku me vlerat e treguesve të performancës për çdo vit të periudhës së planifikimit 7-vjeçar të strategjisë.

Tabela 2-1 bazohet në një tabelë *excel*-i; është krijuar për të ecur paralel me objektivat e misionit; dhe pasqyron çështjet prioritarë si tregues të matshëm performance. Në çdo rast, është dhënë vlera e treguesit të performancës për vitin bazë 2010, nëse ka pasur vlera të tilla. Vlerat e vitit bazë janë marrë nga baza e të dhënave të Njësisë së Monitorimit të Treguesve të Punës dhe Vlerësimit Krahasues, duke pasur vitin bazë si pikënisje. Grupi i Punës i ngarkuar me hartimin e Strategjisë së Sektorit, përcaktoi një vlerë të realizueshme për treguesin e performancës në vitin e fundit të periudhës së planifikimit, 2011-2017, si edhe përcaktoi vlera të ndërmjetme për secilin prej 7 viteve të periudhës së planifikimit.

Tabela 2-1  
QËLLIMET STRATEGJIKE DHE TREGUESIT E PUNËS

Obj./ prior.	Objektivi i politikës	Indikat. fakt. 2010	Planifikimi për fundvitin						
			2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017
<b>1</b>	<b>Zgjerimi dhe përmirësimi i cilësisë së shërbimeve të ujësjellës-kanalizimeve</b>								
1.a.1	Mbulimi me ujësjellës për zonën urbane	90.7%	91%	92%	93%	94%	95%	96%	98%
1.a.2	Mbulimi me ujësjellës për zonën rurale	57.0%	60%	64%	70%	76%	79%	82%	85%
1.b.1	Mbulimi me kanalizime për zonën urbane	83.0%	83%	84%	85%	85%	86%	87%	87%
1.b.2	Mbulimi me kanalizime për zonën rurale	10.9%	11%	13%	15%	20%	25%	35%	45%
1.c.1	Vazhdimësia e shërbimit të furnizimit me ujë (orë/ditë)	11 .1	12	13	14	15	16	18	20
1.d.1	Mbulimi me shërbim të trajtimit të urave të ndotura me impiante trajtimi	4.0%	7%	15%	20%	25%	30%	35%	40%
1.e.1	Hartimi dhe realizimi periodik i vrotimit të nevojave kombëtare për të përcaktuar projektet prioritarë për investime					100%	100%	100%	100%
<b>2</b>	<b>Orientimi i ndërmarrjeve të ujësjellësit drejt parimeve të kontrollit dhe rikuperimit të plotë të kostove</b>								

2.a.1	Mbulimi i Kostos Direkte të Operimit (KDO) me të ardhurat	93.4%	95%	95%	100%	100%	100%	100%	100%
2.a.2	Mbulimi i Kostos Direkte të Operimit (KDO) me arkëtimet	78.6%	80%	85%	90%	100%	100%	100%	100%
2.a.3	Mbulimi i Kostos Totale të Operimit (KTO) me të ardhura	66.6%	68%	70%	72%	74%	76%	78%	80%
2.a.4	Mbulimi i Kostos Totale të Operimit (KTO) me arkëtimet	56.1%	58.5%	61.6%	64.8%	68.1%	71.4%	74.9%	78.4%
2.a.5	Mbulimi i fondit rezervë të kapitalit (riparim/zëvendësim dhe kapitali i ri) për sektorin me të ardhura	0%	0%	0%	10%	20%	30%	40%	50%
2.a.6	Norma e përgjithshme e arkëtimet	84.2%	86%	88%	90%	92%	94%	96%	98%
2.b.1	Reduktimi i nivelit të ujit pa të ardhura	63.2%	60%	57%	54%	51%	48%	45%	40%
2.b.2	Niveli i matjes së konsumit të ujit i shprehur si numër lidhjesh	44.6%	48%	52%	60%	65%	72%	80%	85%
2.b.3	Niveli i matjes së prodhimit të ujit i shprehur si numër matësish	16.0%	30%	60%	90%	100%	100%	100%	100%
2.b.4	Niveli i matjes së shpërndarjes së ujit i shprehur si numër matësish	12.0%	13%	30%	60%	90%	100%	100%	100%
2.c.1	Krijimi i një programi, sipas së cilit të gjitha ndërmarrjet e licencuara të ujit duhet të kenë një sistem menaxhimi asetesh të dokumentuar				100%	100%	100%	100%	100%
2.d.1	Të gjitha shërbimet e licencuara të ujit duhet të zhvillojnë dhe të përditësojnë vit pas viti një plan biznesi pesëvjeçar				100%	100%	100%	100%	100%
2.e.1	Zhvillimi dhe zbatimimi i një programi subvencionimi për familjet e varfra				100%	100%	100%	100%	100%

### KAPITULLI 3 POLITIKAT DHE PLANET E VEPRIMIT

Ky kapitull i strategjisë sektoriale trajton çështje specifike të politikave sektoriale që do të kenë ndikim në objektivat e misionit, si edhe qëndrimin e qeverisë në lidhje me këto çështje. Më pas, kapitulli paraqet plane të përmbledhura veprimi, që duhet të zhvillohen në plane zbatimi më të detajuara nga institucioni përgjegjës qendror, me qëllim që të realizohen përmirësimet e dëshiruara në sektorin që do të arrijnë treguesit sasiorë të performancës së shtjelluar dhe të paraqitur në kapitullin 2.

Politika nr.1 - Juridiksioni i politikave tarifore

Politika tarifore përfshin të gjithë ofruesit e licencuar të shërbimeve të ujësjetës-kanalizimeve pa përjashtim, me qëllim që të rregullojë me efikasitet shërbimet si në zonat urbane ashtu edhe në ato rurale.

Politika nr.2 - Diferencimi dhe strukturat e tarifave

Është e pranueshme që tarifat të mos jenë të njëjta për të gjithë ofruesit e shërbimeve, pasi kjo reflekton kostot e ndryshme të shërbimit. Operatorët mund të zgjedhin midis një game të gjerë strukturash tarifash, megjithatë duhet të synohet drejt kalimit gradual në tarifa uniforme që janë transparente, të barabarta dhe lehtësisht të kuptueshme për konsumatorin. Mund të shqyrtohet vendosja e tarifave sezonale për rajonet bregdetare turistike, ku kërkesa maksimale në verë e rrit pamjaftueshmërinë e ujit. Do të ishte e preferueshme një strukturë tarifash që bazohet në vlera fikse dhe në volum, pasi kështu operatorit i garantohen hyrje të parashikueshme parash gjatë të gjitha periudhave të vitit.

Politika nr.3 – Subvencionimet e kryqëzuara ndërmjet kategorive të konsumatorëve

Në përputhje me parimin e trajtimit të barabartë të konsumatorëve, si edhe për të arritur eficientë afatgjatë të sektorit, tendenca e çmimvënies duhet të jetë për aplikimin e tarifave të njëjta për njësi, për të gjitha kategoritë e klientëve. Kjo duhet të bëhet gradualisht në periudhën 7-vjeçare.

Politika nr.4 – Rikuperimi i kostos nga ofruesit e shërbimeve

Për ofruesit e shërbimeve të ujësjellës-kanalizimeve duhet të aplikohet parimi i rikuperimit të plotë të kostos, gjë që është në përputhje me direktivat e BE-së për ujin. Ky është proces gradual, bazuar në të dhënat për aftësinë e konsumatorëve për të paguar në të gjitha zonat e shërbyera të vendit, dhe duhet të zbatohet kurdo dhe kudo që është i mundur. Është detyrë e Entit Rregullator të Ujit që të bëjë vlerësim periodik të mundësisë praktike të rikuperimit të plotë të kostos nga tarifave dhe të përfshijë vlerësimin dhe rekomandimet e veta në raportin vjetor. Për qëllime të periudhës së planifikimit, më poshtë jepen objektiva të ndërmjetëm që varen nga efikasiteti i arkëtimeve:

i) Të arrihet brenda 3 vitesh përmes tarifave dhe arkëtimeve, rikuperimi i kostos për këto zëra:

1. kostot e operimit dhe të mirëmbajtjes (O&M) të sistemeve të ujësjellës-kanalizimeve;

ii) Të arrihet brenda 7 vitesh, përmes tarifave dhe arkëtimeve, rikuperimi i kostove për këto zëra:

1. kostot e amortizimit që presupozon vlerën e zëvendësimit të aseteve ekzistuese me 50%;

2. shlyerja e borxhit;

3. tatimet, detyrimet.

Politika nr.5 - Aplikimi i subvencioneve të shenjëstruara

Shërbimet bazë të furnizimit me ujë dhe kanalizime duhet t'u sigurohen të gjithë qytetarëve të Republikës së Shqipërisë, aty ku është ekonomikisht rentabël ose për mbrojtjen e shëndetit publik. Familjet e varfra që nuk mund të paguajnë koston e shërbimit, duhet të kenë akses në shërbime bazë përmes mekanizmave subvencionues adekuat.

Aktualisht, subvencionimi realizohet në dy mënyra: subvencionim i kryqëzuar i strukturës tarifore dhe subvencionim i drejtpërdrejtë i operatorëve nga qeveria përmes pushtetit vendor. Gjatë periudhës së planifikimit, qeveria do të punojë që të përgatitë dhe të zbatojë një program subvencionimi të shenjëstruar në favor të familjeve në nevojë, me qëllim që të ndërpritet praktika e subvencionimit të humbjeve të ofruesve të shërbimeve.

Qeveria është e vetëdijshme që ky ndryshim në subvencionime kërkon kritere të përshtatshme për të përfituar subvencionim dhe ngritjen e përditësimin e një baze të dhënash për familjet që përfitojnë, si edhe ngritjen e një mekanizmi të mirëmenduar për shpërndarjen e subvencioneve; mekanizmi duhet të jetë i zhvilluar mirë që t'i bëjë ballë përpjekjeve për favorizim, abuzim dhe korrupsion.

Politika nr.6 - Inventarizimi i aseteve dhe vlerësimi i sistemeve të ujësjellës-kanalizimeve

Brenda një periudhe të caktuar, duhet të kryhet inventarizimi i aseteve dhe vlerësimi i të gjitha sistemeve të ujësjellës-kanalizimeve urbane e rurale të licencuara, përfshi sistemin e një NJQV-je të vetme apo sistemin e shumë NJQV-ve. Ky proces inventarizimi dhe vlerësimi duhet të kryhet në bazë të kriterëve që përcakton Enti Rregullator i Ujit dhe pastaj t'i dorëzohet Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZQRPP). Të gjitha ndryshimet në inventar duhet të pasqyrohen dhe të raportohen çdo vit në ZQRPP.

Politika nr.7 - Hartimi i një ligji të ri specifik për shërbimet e ujësjellës-kanalizimeve

Qeveria ka marrë vendim të nxitë bashkimin e zonave të shërbimit me ujësjellës-kanalizime për të arritur ekonominë e shkallës në këtë sektor. Në këtë drejtim, duhet shqyrtuar hartimi i një ligji organik për shërbimet e ujësjellës-kanalizimeve, që të përcaktojë: statutet dhe pronësinë e ndërmarrjeve rajonale të ujësjellësit, si edhe të ndërmarrjeve rajonale të trajtimit të ujërave të ndotur, parimet për inventarin dhe vlerësimin e aseteve, ndarjen e titujve të përdorimit nga e drejta e përdorimit, të drejtat dhe detyrimet e secilit aktor kryesor, pronësinë e përzier publike-private, strukturat e shërbimeve të bashkuara të shitjes me pakicë, si edhe hyrjen dhe daljen nga tregu.

**Politika nr. 8 - Licencimi i ofruesve të shërbimeve të ujësjellës-kanalizimeve**

Të gjithë ofruesit e shërbimeve të ujësjellës-kanalizimeve që operojnë përmes sistemeve të tubacioneve publike formale, duhet të marrin licencë nga Enti Rregullator i Ujit, sipas kriterëve të përcaktuara nga enti.

**Politika nr.9 - Autorizimi për të zëvendësuar një operator dështues**

Mandati i Entit Rregullator të Ujit duhet të forcohet duke i dhënë të drejtën të ndërhyjë kur operatorët nuk përmbushin standardet, duke autorizuar zëvendësimin e operatorit në fjalë me një tjetër operator (publik apo privat). Operatori alternativ duhet të paguhet nga të ardhurat prej përdoruesve, plus kontributet e pushtetit vendor që përfiton shërbimet, nëse të ardhurat nga tarifat e përdoruesve janë të pamjaftueshme. Pra, nevojitet reagim i menjëhershëm i qeverisë, kur format e tjera të penalteteve shpërfillen ose rezultojnë joefikase. Enti Rregullator i Ujit duhet të zhvillojë dhe të publikojë procedurat që duhen ndjekur për zëvendësimin e operatorit.

**PLANET E PËRMBLEDHURA TË VEPRIMIT**

<b>Objektivi 1 i misionit: Zgjerimi dhe përmirësimi i cilësisë së shërbimeve të ujësjellës-kanalizimeve</b>
<b>Masa prioritare 1.a: Rritja e aksesit të popullsisë urbane dhe rurale në furnizimin me ujë të pijshëm të sigurt</b>
Qëllimi Strategjik: Mbulimi me Furnizim me ujë -Zonat urbane: 98 % Zonat rurale: 85 % Masat: - Llogaritja sasiore e rritjes së pritshme të mbulimit bazuar në programimin aktual të fondeve të ndërmarrjeve të ujësjellësit, duke përdorur masterplanet që do të përgatiten me fondet e KfW-së. - Përcaktimi i mangësive, nëse ka, për të realizuar rritjen e pritshme të mbulimit sipas strategjisë. - Llogaritja sasiore e fondeve shtesë që i duhen ndërmarrjes për të realizuar rritjen e pritshme të mbulimit. - Financim i drejtpërdrejtë i projekteve që do të kontribuojnë në rritjen e mbulimit me furnizim me ujë të pijshëm  Nevojat kapitale të parashikuara: Për zonat urbane: 96.9 miliardë lekë - Për zonat rurale: 106.96 miliardë lekë Institucioni Përgjegjës: Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjellës-Kanalizimeve
<b>Masa prioritare 1.b: Rritja e lidhjeve të popullsisë urbane dhe rurale me rrjetet e grumbullimit të ujërave të zeza</b>
Qëllimi strategjik: Mbulimi me kanalizime –Zonat urbane: 87 % Zonat rurale: 45 % Masat: - Llogaritja sasiore e rritjes së pritshme të mbulimit bazuar në programimin aktual të fondeve për ndërmarrjet e ujësjellësit që të zgjerojnë rrjetin e kanalizimeve. - Përcaktimi i mangësive, nëse ka, për të realizuar rritjen e pritshme të mbulimit sipas strategjisë. - Llogaritja sasiore e fondeve shtesë që i duhen ndërmarrjes për të realizuar rritjen e pritshme të mbulimit. - Financim i drejtpërdrejtë i projekteve që do të kontribuojnë në shtimin e lidhjeve në sistemet e grumbullimit të ujërave të ndotur  Nevojat kapitale të parashikuara: Për zonat urbane: 69.72 miliardë lekë - Për zonat rurale: 52.36 miliardë lekë Institucioni Përgjegjës: Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjellës-Kanalizimeve
<b>Masa prioritare 1.c: Shtim i orëve të shërbimit për popullsinë urbane dhe rurale</b>
Qëllimi strategjik: Vazhdimësia e shërbimit – 20 orë Masat: - Rritja e numrit të orëve të shërbimit (vazhdimësia e shërbimit) është funksion i drejtpërdrejtë i menaxhimit të kërkesës për ujë, gjë që do të rezultojë në faturimin e plotë të lidhjeve të konsumatorëve dhe heqjen e depozitave (mbi tarraca) apo rezervuarëve (në terren) Nevojat kapitale të parashikuara: Asnjë kapital i drejtpërdrejtë i lidhur me këtë masë Institucioni Përgjegjës: Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjellës-Kanalizimeve
<b>Masa prioritare 1.d: Rritja e përqindjes së popullsisë të lidhur me rrjetin e grumbullimit të ujërave të zeza, i lidhur me një impiant përpunimi</b>
Qëllimi strategjik: Mbulimi me kanalizime – Përqindja e popullsisë së mbuluar: 40% Masat: - Llogaritja e Popullsisë Ekuivalente (PE) në të gjitha impiantet e trajtimit që janë aktualisht në fazën e studimit, projektimit dhe ndërtimit, si dhe parashikimi i datave kur do të bëhen funksionale. - Duhet marrë parasysh të gjitha impiantet ekzistuese të trajtimit (PE). - Përcaktimi i kapacitetit të pritshëm të trajtimit (PE) funksional në vitin 2017.

<ul style="list-style-type: none"> <li>- Përcaktimi nëse kapaciteti i pritshëm i trajtimit (PE) do ta përmbushë qëllimin.</li> <li>- Përcaktimi i ecurisë së ndërtimit të tubacioneve kryesore të ujërave të zeza dhe popullsia që do të lidhet me to.</li> <li>- Përcaktimi i nevojës për tubacione/stacione pompimi shtesë.</li> <li>- Programimi i investimeve kapitale për adresimin e nevojave shtesë, nëse ka</li> </ul> <p>Nevojat kapitale të parashikuara: 260.12 miliardë lekë Institucioni përgjegjës: Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjellës-Kanalizimeve</p>
<p><b>Masa prioritare 1.e: Hartimi dhe realizimi 2 herë në vit i vrojtimit të nevojave kombëtare që do të prioritetizojë projektet për investime</b></p> <p>Qëllimi strategjik: Dorëzimi i vrojtimit qeverisë në fund të muajit mars çdo dy vjet, duke filluar me vrojtimin e parë në mars 2014</p> <p>Masat:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Zhvillimi i një metodologjie vrojtimi që duhet të plotësohet nga çdo ndërmarrje e licencuar ujësjellës-kanalizimesh, që do të shërbejë për vlerësimin sasior të nevojave kapitale të sistemit bazuar në elementet e sistemit dhe standardet kombëtare.</li> <li>- Plotësimi i nevojave fizike të vrojtimit me të dhëna socio-ekonomike që shërbejnë për të mundësuar sistem vlerësimi me pikë.</li> <li>- Përgatitja e një raporti për qeverinë, çdo dy vjet, mbi nevojat e sektorit për investime që të përmbushë standardet kombëtare.</li> </ul> <p>Nevojat kapitale të parashikuara: Asistenca teknike që nevojitet për projektimin dhe realizimin e vrojtimit dhe mbledhjen e të dhënave, e llogaritur 0.7 miliard lekë Institucioni përgjegjës: Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjellës-Kanalizimeve</p>
<p><b>Objektivi 2 i misionit: Orientimi i ndërmarrjeve të ujësjellësit drejt parimeve të kontrollit dhe rikuperimit të plotë të kostove</b></p> <p><b>Masa prioritare 2.a: Orientimi i shërbimeve, në mënyrë të tillë që të rikuperohen plotësisht kostot operacionale dhe të mirëmbajtjes, shlyerja e borxhit, dhe shpenzimet kapitale për riparime dhe zëvendësime</b></p> <p>Qëllimet strategjike: Mbulimi 100% i kostove direkte nga të ardhurat; Mbulimi 100% i kostove direkte nga arkëtimet; Mbulimi 80% i kostove totale nga të ardhurat; Mbulimi 78% i kostove totale nga arkëtimet; Mbulimi 50% i kostove totale për rezervat (për riparime kapitale dhe zëvendësime); Arkëtimi në një shkallë prej 98% i faturimeve aktuale</p> <p>Masat:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Pushteti qendror do të heqë gradualisht fondet për pushtetin vendor që shërbejnë për të kompensuar humbjet operative të ndërmarrjeve të ujësjellës-kanalizimeve.</li> <li>- Para se të vendosë ndryshimet e tarifave, Enti Rregullator i Ujit do t'i shqyrtojë me kujdes planet e ndërmarrjeve për përmirësimin e performancës së tyre</li> </ul> <p>Kostot kapitale të parashikuara: Asnjë kapital nuk lidhet drejtpërdrejt me këtë masë Institucioni përgjegjës: Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjellës-Kanalizimeve</p>
<p><b>Masa prioritare 2.b: Fokusimi i investimeve në reduktimin e konsumimit të ujit dhe energjisë që nuk gjeneron të ardhura</b></p> <p>Qëllimi strategjik: Reduktimi i ujit pa të ardhura deri në 40% të ujit të dërguar në sistem;</p> <p>Arritja e matjes së 85% të konsumit; Arritja e 100% të matjes në zona; Arritja e 100% të matjes së prodhimit</p> <p>Masat:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Realizimi i një vlerësimi të detajuar për nevojat e matjes, për të gjitha ndërmarrjet e ujësjellësit të licencuara.</li> <li>- Ngritja e një programi matjeje dhe kanalizimi i fondeve për të mbështetur qëllimet strategjike.</li> <li>- Shqyrtimi i blerjes së matësve standardë shtëpiakë dhe tenderimi vetëm i instalimit</li> </ul> <p>Kostot kapitale të parashikuara: Matësit e konsumatorëve: 40.46 miliardë lekë Matësit e prodhimit: 0.7 miliard lekë Matësit zonalë: 0.42 miliard lekë Institucioni përgjegjës: Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjellës-Kanalizimeve</p>

<p><b>Masa prioritare 2.c: Krijimi i një programi sipas së cilit të gjitha shërbimet e licencuara të ujit duhet të kenë një sistem menaxhimi asetesh plotësisht të dokumentuar</b></p> <p>Qëllimi strategjik: Të gjitha ndërmarrjet e ujësjellësve të licencuara duhet të kenë sisteme funksionale të menaxhimit të aseteve deri në fund të vitit 2013</p> <p>Masat:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Marrja e masave për realizimin e një kursi trajnimi për përgatitjen e një programi dhe sistemi për menaxhimin e aseteve.</li> <li>- Marrja e masave për sigurimin e asistencës teknike për ndërmarrjet e ujësjellësve të licencuara me staf të kufizuar për përgatitjen e një programi dhe sistemi për menaxhimin e aseteve</li> </ul> <p>Kostot kapitale të parashikuara: Asistencë teknike që nevojitet për projektimin dhe ngritjen e programeve dhe sistemeve të menaxhimit të aseteve vlerësohet të jetë 1.4 milion lekë</p> <p>Institucioni përgjegjës: Grupi i punës i përbërë nga: Komisioni Kombëtar i Rregullimit të Ujit (kryesues) dhe Drejtoria e Përgjithshme e Ujësllës-Kanalizimeve</p>
<p><b>Masa prioritare 2.d: Të gjitha shërbimet e licencuara të ujit duhet të zhvillojnë dhe të përditësojnë vit pas viti një plan biznesi pesëvjeçar</b></p> <p>Qëllimi strategjik: Të gjitha ndërmarrjet e ujësjellësve të licencuara do të kenë plan biznesi pesëvjeçar që ta përditësojnë çdo vit deri në fund të vitit 2012</p> <p>Masat:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Rregullatori i ndërmarrjeve të ujësjellësit do t'u kërkojë plan biznesi pesëvjeçar të përditësuar, kur ato aplikojnë për ndryshim tarifash pas fundit të vitit 2012.</li> <li>- Drejtoria e Përgjithshme e Ujësllës-Kanalizimeve duhet të ofrojë kurs trajnimi për planifikimin e biznesit, bazuar në modelin standard të planifikimit të biznesit të miratuar nga grupi ndërmarrës i punës</li> </ul> <p>Kostot kapitale të parashikuara: Asnjë kapital nuk lidhet drejtpërdrejt me këtë masë</p> <p>Institucioni Përgjegjës: Enti Rregullator i Ujit</p>
<p><b>Masa prioritare 2.e: Zhvillimi dhe zbatimi i një programi subvencionimi për familjet e varfra</b></p> <p>Qëllimi strategjik: Hartimi i një programi subvencionimi operacional deri në fund të vitit 2012</p> <p>Masat:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Rishikimi i situatës aktuale dhe i asistencës që u ofrohet familjeve të varfra për qëllime të tjera.</li> <li>- Hartimi dhe raportimi i opsioneve që garantojnë barazi dhe minimizojnë shpenzimet administrative deri në fund të vitit 2011.</li> <li>- Hartimi i programit dhe përgatitja për miratim nga Këshilli i Ministrave deri në fund të muajit qershor 2012.</li> <li>- Programi duhet të jetë plotësisht funksional deri në fund të vitit 2012</li> </ul> <p>Kostot kapitale të parashikuara: Asnjë kapital nuk lidhet drejtpërdrejt me këtë masë</p> <p>Institucioni përgjegjës: Grupi i përbashkët i punës: Ministria e Brendshme (kryesuese) Drejtoria e Përgjithshme e Ujësllës-Kanalizimeve; Ministria e Financave dhe Enti Rregullator i Ujit</p>
<p><b>Objekti 3 i misionit: Përmirësimi i drejtimit dhe i rregullimit të sektorit</b></p> <p><b>Masa prioritare 3.a: Përmirësimi i mëtejshëm i rolit dhe funksionit të Entit Rregullator të Ujit</b></p> <p>Qëllimi strategjik: Rregulluesi të ushtrojë plotësisht rolin dhe përgjegjësitë e tij në përputhje me legjislacionin përkatës deri në fund të vitit 2012</p> <p>Masat:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Përgatitja e procedurave për licencimin e sistemeve komunale të ujësjellës-kanalizimeve.</li> <li>- Përcaktimi dhe miratimi i kompetencave për të ushtruar ndërhyrje në sistemet me shkelje të rënda</li> </ul> <p>Kostot kapitale të parashikuara: Asnjë kapital nuk lidhet drejtpërdrejt me këtë masë</p> <p>Institucioni përgjegjës: Enti Rregullator i Ujit</p>
<p><b>Masa prioritare 3.b: Zgjerim i aktiviteteve licencuese të Entit Rregullator të Ujit me synim licencimin e të gjitha sistemeve të ujësjellës-kanalizimeve</b></p> <p>Qëllimi strategjik: Licencimi i të gjitha sistemeve formale me tubacione të ujit deri në fund të vitit 2012.</p> <p>Masat:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Përcaktimi nëse ekziston nevoja për më shumë se një kategori licence dhe hartimi i udhëzimeve për licencimin e kategorive të ndryshme.</li> <li>- Bashkëpunimi me autoritetet e qarqeve, organizimi i takimeve informuese për t'i njoftuar komunat për detyrimin e licencimit të sistemeve që nuk operohen nga ndërmarrjet e ujësjellësve (sh.a.)</li> </ul> <p>Kostot e parashikuara kapitale: Asnjë kapital nuk lidhet drejtpërdrejt me këtë masë</p> <p>Institucioni përgjegjës: Enti Rregullator i Ujit</p>
<p><b>Masa prioritare 3.c: Hartimi dhe përhapja e një kontrate tip për dhënie të shërbimeve</b></p> <p>Qëllimi strategjik: Të miratohet kontrata tip për dhënie të shërbimeve për ndërmarrjet e ujësjellësit dhe pushtetin vendor që të vihet në përdorim që në fund të vitit 2012</p> <p>Masat:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Ngritja e një grupi pune me bazë të gjerë ku përfshihet shoqata e bashkive, shoqata e komunave, Shoqata e Ujësllës-Kanalizimeve dhe Ministria e Brendshme.</li> <li>- Angazhimi i një konsulenti që të asistojë në përgatitjen e kontratave të dhënies së shërbimeve që do të rishikohen nga grupi i punës.</li> <li>- Dhënie asistencë direkte për NJQV-të pilot dhe ndërmarrjet e ujësjellësit pilot në negociatat përfundimtare për miratimin e një kontrate, duke përdorur kontratën tip</li> </ul> <p>Kostot kapitale të parashikuara: Nevojitet asistencë teknike për ekspertizën për kontratën tip të dhënies së shërbimeve dhe për negociatat pilot, që llogaritet të jetë 0.7 miliardë lekë</p> <p>Institucioni përgjegjës: Enti Rregullator i Ujit</p>

<p><b>Masa prioritare 3.d: Forcimi i sekretariatit teknik të këshillit kombëtar të ujit dhe agjencive të baseneve të lumenjve</b></p> <p>Qëllimi strategjik: Drejtoria e Përgjithshme e Administrimit të Ujërave do të ketë stafin e nevojshëm dhe do të ushtrojë funksionet që të shërbejë si sekretariat teknik, si edhe plotësimi i agjencive të baseneve të lumenjve me stafin e nevojshëm që u mundësojnë realizimin e funksioneve të ngarkuara me ligj, deri në fund të vitit 2013</p> <p>Masat:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Plotësimi i sekretariatit teknik me stafin e duhur të kualifikuar.</li> <li>- Plotësimi me staf i agjencive të baseneve të lumenjve me stafin e duhur të kualifikuar.</li> <li>- Ofrimi i asistencës teknike për forcim kapacitetesh të sekretariatit teknik dhe të agjencive të baseneve të lumenjve.</li> <li>- Licencimi i të gjitha pikave të nxjerrjes së ujit siç e parashikon ligji.</li> <li>- Vendosja e autoritetit të tarifës së përdoruesit (lek për metër kub) për të gjithë ujin e nxjerrë nga mjedisi natyror për konsum ose për aktivitet ekonomik.</li> <li>- Kreditimi i të gjitha fondeve të mbledhura nga nxjerrja e ujit në një llogari për t'i bërë sekretariatit teknik dhe agjencitë e baseneve të lumenjve financiarisht të vetëqëndrueshëm/me si enti rregullator i ujit</li> </ul> <p>Kostot kapitale të parashikuara: Asistenca teknike që nevojitet për forcimin e kapaciteteve vlerësohet të jetë 2.8 miliardë lekë</p> <p>Institucioni përgjegjës: Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave</p>
---

<p><b>Objektivi 4 i misionit: Investime për rritjen e kapaciteteve të fuqisë punëtore të sektorit</b></p> <p><b>Masa prioritare 4.a: Hartimi i një programi kombëtar trajnimi dhe certifikimi, sipas kërkesave për trajnim të të gjitha ndërmarrjeve të ujësjellësit</b></p> <p>Qëllimi strategjik: Numri i personelit të lartë drejtues të trajnuar zyrtarisht dhe të certifikuar për pozicionet e tyre të punës të jetë 150 deri në vitin 2017</p> <p>Numri mesatar i orëve të trajnimit për punonjës të arrijë 40 orë në vit deri në vitin 2017</p> <p>Masat:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Drejtoria e Përgjithshme duhet të hartojë një program trajnimi kombëtar për punonjësit e ndërmarrjeve të ujësjellësit me kurse specifike të ofruara përmes një larmie institucionesh dhe metodash trajnimi.</li> <li>- Drejtoria e Përgjithshme duhet të identifikojë pozicionet e punës që klasifikohen të nivelit të lartë drejtues dhe të hartojë kurse trajnimi specifike që ata të certifikohen për të kryer funksionet e tyre</li> </ul> <p>Kostot kapitale të parashikuara: Kapitali fillestar në asistencë teknike që nevojitet për hartimin dhe përdorimin e programit të trajnimit dhe certifikimit vlerësohet të jetë 4.2 miliardë lekë</p> <p>Institucioni përgjegjës: Drejtoria e Përgjithshme e Ujësllës-Kanalizimeve</p>
<p><b>Masa prioritare 4.b: Të gjithë anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës të shërbimeve të licencuara të ujit t'u kërkohe të marrin pjesë dhe të përfundojnë trajnimin për rolet, detyrat, autoritetet dhe përgjegjësitë e tyre</b></p> <p>Qëllimi strategjik: Të gjithë anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës ta mbarojnë këtë kurs trajnimi deri në fund të vitit 2011</p> <p>Masat:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Të informohen të gjithë anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës rreth detyrimit për ndjekjen e kursit të trajnimit si parakusht për t'u paguar si anëtarët të Këshillit.</li> <li>- Bashkëndimi me Shoqatën e Ujësllës-Kanalizimeve të Shqipërisë për programin e trajnimit dhe pjesëmarrësit që përfundojnë kursin</li> </ul> <p>Kostot kapitale të parashikuara: Asnjë kapital nuk lidhet drejtpërdrejt me këtë masë</p> <p>Institucioni përgjegjës: Enti Rregullator i Ujit</p>

<p><b>Objektivi 5 i misionit: Progresi drejt harmonizimit të legjislacionit të brendshëm me direktivat e BE-së për ujin</b></p> <p><b>Masa prioritare 5.a: T'i propozohet parlamentit legjislacion për ujin që është i harmonizuar me direktivat e BE-së për ujin</b></p> <p>Qëllimi strategjik: Arritja e harmonizimit të legjislacionit shqiptar me direktivat e BE-së për ujin dhe me parimin e rikuperimit të plotë të kostove deri në fund të vitit 2013</p> <p>Masat:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Direktiva kuadër e ujit (2000/60/KE) e datës 23 tetor 2000, për menaxhimin e burimeve ujore, e cila ofron një sistem të vetëm menaxhimi të ujit nëpërmjet baseneve të lumenjve, si njësi natyrore gjeografike dhe hidrike, në kontrast me kufijtë administrativë dhe politikë. Direktiva përcakton planin e menaxhimit të baseneve lumore si instrumentin kryesor për të ndihmuar në parandalimin e shkatërrimit të burimeve ujore.</li> <li>- Direktiva e Ujit të Pijshëm (98/83/KE) e datës 3 nëntor 1998, një kompleks normash që synojnë mbrojtjen e shëndetit të njeriut duke vendosur kriteret për shëndetin dhe pastërtinë.</li> <li>- Direktiva për trajtimin e ujërave të zeza urbane (91/271/EEC), e datës 21 maj 1991, e cila synon mbrojtjen e mjedisit nga pasojat negative për shkak të derdhjes së ujërave të zeza urbane.</li> <li>- Parimet e rikuperimit të plotë të kostove sipas vendimit COM (2000)477, të cilat përcaktojnë se politikat e përcaktimit të çmimeve të ujit duhet të ofrojnë stimuj të mjaftueshëm që përdoruesit t'i përdorin burimet ujore me efikasitet dhe të kontribuojnë për mbulimin e kostove të shërbimeve ujore duke përfshirë ato që lidhen me mjedisin dhe burimet</li> </ul> <p>Kostot kapitale të parashikuara: Asnjë kapital nuk lidhet drejtpërdrejt me këtë masë</p> <p>Institucioni përgjegjës: Grupi i përbashkët i punës: Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave (kryesues), Drejtoria e Përgjithshme e Ujësllës-Kanalizimeve dhe Enti Rregullator i Ujit</p>
---



<p><b>Masa prioritare 5.b: Hartimi i një ligji të ri specifik për shërbimet e ujësjellës-kanalizimeve</b>  Qëllimi strategjik: Ligji të jetë plotësisht funksional deri në fund të muajit qershor 2013  Masat:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Shqyrtimi i mangësive në zbatimin e ligjit për shoqëritë tregtare në lidhje me format e korporatave në kuadrin e rajonalizimit aktual apo të ardhshëm.</li> <li>- Shqyrtimi i përfitimeve që mund të sjellë zëvendësimi i ligjit të kompanive tregtare me një ligj për korporatat publike.</li> <li>- Sqarimi i çështjeve të pronësisë individuale dhe të përbashkët, sa i përket aseteve në kuadrin e një strukture rajonale shërbimi</li> </ul> <p>Kostot kapitale të parashikuara: Asistenca teknike që nevojitet për hartimin e ligjit vlerësohet të jetë 0.7 miliard lekë  Institucioni përgjegjës: Grupi i përbashkët i punës: Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjellës-Kanalizimeve, Ministria e Brendshme, Ministria e Financave dhe Enti Rregullator i Ujit</p>
<p><b>Masa prioritare 5.c: Fillimi i një programi që inkurajon bashkimin e ndërmarrjeve të ujësjellësit</b>  Qëllimi Strategjik: Pakësimi i numrit të ndërmarrjeve të ujësjellësit (sh.a.) në 26  Masa:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Zbatimi i planit të veprimit nga “Studimi i fizibilitetit të ndërmarrjeve rajonale të sektorit të ujësjellës-kanalizimeve në Shqipëri”.</li> <li>- Dhënia e kapitalit “fillestar” për sh.a., të që dëshirojnë të bashkohen, që mund të jetë në formën e masterplanit të detajuar dhe studimeve të fizibilitetit, sisteme informimi gjeografik, sisteme kontabiliteti dhe faturimi, automjete etj.</li> </ul> <p>Kostot Kapitale të parashikuara: 19.6 miliardë lekë (7 bashkime me 2.8 miliardë lekë secili)  Institucioni Përgjegjës: Drejtoria e Përgjithshme e Politikave të Rajonalizimit të Ujësjellës-Kanalizimeve dhe mbetjet e ngurta</p>

## KAPITULLI 4 IMPLIKIMET E BURIMEVE

Ky kapitull i strategjisë së sektorit paraqet shpërndarjen e burimeve sipas lidhjes së tyre me politikat. Objektivat e misionit dhe çështjet prioritare që janë shtjelluar më lart për të arritur tek impakti që do të kenë këto vendime në nevojat e ardhshme për financim. Këto nevoja për financim mund të merren direkt nga thesari i shtetit, mbështetja e donatorëve në formë grantesh ose kredish, apo edhe në forma të tjera kapitali të angazhuara apo asistence teknike.

Është e kuptueshme se strategjia e sektorit nuk përbën zotim për dhënie fondesh publike siç ndodh me buxhetin vjetor apo buxhetin afatmesëm. Roli i strategjisë së sektorit, sa i përket përcaktimit sasior të nivelit të investimeve/shpenzimeve kapitale të parashikuara, është që të shërbejë si dokument reference që orienton qeverinë në planet e saj të shpenzimeve. Megjithatë, strategjia e sektorit shërben për të shprehur qartë prioritetet. Në këtë mënyrë, implikimet e mundshme fiskale të politikave të deklaruara dhe çështjeve prioritare, janë krahasuar me një kuadër më të gjerë të mundshëm burimesh.

### 4.1 Nevojat kapitale në mbështetje të objektivave strategjike dhe prioriteteve

Me përkufizimin e treguesve të punës, përcaktimin e vitit bazë dhe vlerën e treguesve të punës që duhet arritur deri në vitin 2017, ishte e mundur të përcaktohej nëse ekzistonin nevoja kapitale për arritjen e vlerave të synuara. Në çdo rast ku kishte nevojë për kapital, është vendosur një bazë e matshme për llogaritjen e këtij kapitali.

Tabela 4-1 merr parasysh, për çdo masë prioritare që kërkon investim kapital, një masë për konvertimin e vlerës së synuar në kosto kapitale, për shembull: rritja e mbulimit të zonave urbane me rrjet furnizimi uji të pijshëm. Në këtë rast është numri i lidhjeve të reja që nevojiten për arritjen e treguesit të synuar çdo vit, shumëzuar me koston e parashikuar kapitale për njësi për shtimin e një lidhjeje të re.

Tabela 4-1

**KOSTOT KAPITALE PËR NJËSI QË PËRDOREN PËR LLOGARITJEN  
E NEVOJAVE KAPITALE**

<b>Kosto</b>	<b>Për lidhje (000 lekë)</b>	<b>Për person (000 lekë)</b>
Rrjet ujësjellës	2,100	420
Rrjet kanalizimesh	2,450	490
Impiant trajtimi	1,400	280
Ujëmatës familjar	140	24
Ujëmatës prodhimi	2,134	-
Ujëmatës zonalë	1,400	-

Norma në llogaritje: Norma vjetore e rritjes së popullsisë (INSTAT) 0.4%, 1 lidhje me ujësjellës-kanalizimet përbëhet nga 5 persona, 1 ujëmatës zonal për 1 500 lidhje .

Qëllimi i kostove të kapitalit për njësi, paraqitur në tabelën 4-1 është që të japin një bazë të arsyeshme për të qenë në gjendje të dimë nevojat totale për investime kapitale në vit për periudhën e planifikimit të strategjisë, siç jepet në tabelën 4-2. Numri i elementeve në tabelën 4-2 është më i vogël sesa në tabelën 4-1, pasi jo të gjitha çështjet prioritare kërkojnë investime kapitale për t'u zbatuar.

Është planifikuar të përgatitet një masterplan kombëtar për ujësjellës-kanalizimet, i cili pritet të përfundohet në fund të vitit 2012. Ky masterplan dhe programi kapital që pritet të konturojë për sektorin e ujësjellës-kanalizimeve, do të ofrojë një bazë më të saktë në lidhje me nevojat për investime kapitale. Me të përfunduar ky masterplan, Strategjia sektoriale do të përditësohet për të pasqyruar programin e investimeve kapitale të miratuara që parashikon masterplani.

Tabela 4-2  
Nevojat kapitale për mbështetjen e objektivave strategjikë

Nr. obj./prior.	Objektivi i politikës	Përshkrimi	Investimi kapital sipas viteve (000 lekë)						Investimi kapital total (lekë)	
			2011	2012	2013	2014	2015	2016		2017
<b>1</b>	<b>Zgjerimi dhe përmirësimi i cilësisë së shërbimeve të ujësjellës-kanalizimeve</b>									
1.a.1	Mbulimi me ujësjellës për zonën urbane	Numri i lidhjeve: familjarë me ujësjellës (urbane)	6,380,702	13,198,367	13,289,906	13,381,968	13,474,552	13,567,662	23,543,110	96,836,266
1.a.2	Mbulimi me ujësjellës për zonën rurale	Numri i lidhjeve: familjarë me ujësjellës (rurale)	11,399,142	15,033,583	22,271,745	22,446,287	11,854,317	11,944,805	12,035,827	106,985,704
1.b.1	Mbulimi me kanalizime për zonën urbane	Numri i lidhjeve: familjarë me kanalizime (urbane)	3,578,458	14,457,656	14,558,946	3,708,837	14,719,459	14,822,320	3,841,840	69,687,515
1.b.2	Mbulimi me kanalizime për zonën rurale	Numri i lidhjeve: familjarë me kanalizime (rurale)	212,858	3,045,349	3,069,450	7,599,600	7,660,037	15,290,877	15,412,600	52,290,770
1.d.1	Mbulimi me shërbim të trajtimit të ujrave të ndotura me impiante trajtimi	Numri i lidhjeve: familjarë me kanalizime të lidhura me impiante trajtimi	21,207,524	56,676,476	35,864,537	36,149,759	36,436,689	36,725,335	37,015,709	260,076,028
<b>2</b>	<b>Orientimi i ndërmarrjeve të ujësjellësit drejt parimeve të kontrollit dhe rikuperimit të plotë të kostove</b>									
2.b.2	Niveli i matjes së konsumit të ujit i shprehur si numër lidhjesh	Numri i lidhjeve: familjarë me matës	2,999,097	3,885,111	7,385,843	5,398,207	6,766,893	7,839,876	6,150,688	40,425,712
2.b.3	Niveli i matjes së prodhimit të ujit i shprehur si numër matësish	Numri i ujëmatësve të prodhimit	106,545	228,310	228,310	76,103	-	-	-	639,266
2.b.4	Niveli i matjes së shpërndarjes së ujit i shprehur si numër matësish	Numri i ujëmatësve zonale	4,706	80,000	141,176	141,176	47,059	-	-	414,118
	<b>TOTAL</b>		<b>4,589,028</b>	<b>106,604,850</b>	<b>96,809,911</b>	<b>88,901,935</b>	<b>90,959,006</b>	<b>100,190,874</b>	<b>97,999,772</b>	<b>627,355,374</b>

#### 4.2 Nevojat për kapitale shtesë për investimet e shtyra në menaxhimin e aseteve

Sigurisht që tabela 4-2 vetëm sa përpiket të reflektojë investimet kapitale, të cilat normalisht do të përkufizoheshin si “investime të reja kapitale”, dhe jo “ripërtëritje, riparim dhe zëvendësim kapital”. Realiteti në Shqipëri është që disa pjesë të konsiderueshme të investimeve kapitale, që janë bërë deri tani dhe që vazhdojnë të bëhen, janë në të vërtetë për ripërtëritje kapitale, ose për riparim dhe zëvendësim, për shkak të investimeve të shtyra për një kohë të gjatë në menaxhimin e aseteve, dhe jo gjithmonë për shtim kapacitetesh të reja apo zgjerim me shërbime të reja.

Për t'u përpjekur për të kuptuar dhe për t'i reflektuar këto lloje investimesh, si pjesë e nevojës së përgjithshme të sektorit të ujësjellës-kanalizimeve, tabela 4-3 është përgatitur për të bërë një vlerësim të përafërt të këtyre llojeve të veçanta të investimeve/nevojave kapitale që do të kërkojnë shpenzime kapitale gjatë gjithë periudhës së planifikimit.

Sfida që duhet të adresohet në përpjekjet për të vlerësuar kostot e menaxhimit afatgjatë të shtyrë të aseteve që janë akumuluar në sistemin e ujësjellës-kanalizimeve, ka qenë mungesa e një vlerësimi të besueshëm të vlerësimit të aseteve në vend. Sistemi i monitorimit të treguesve të punës dhe vlerësimit krahasues, i cili mbledh të dhënat e disponueshme për asetet fikse në sistemin e ujësjellësit ashtu edhe të kanalizimeve, reflekton vlera shumë të ulëta (ujësjellësit: 118,156,218 lekë dhe kanalizimet: 26,342,505 lekë). Këto të dhëna nuk ndihmojnë shumë për adresimin e kësaj çështjeje.

Përqasja e përdorur për të arritur te vlerat e përdorshme ka qenë vlerësimi me efektshmëri i kostos së zëvendësimit të të dyja sistemeve, duke përdorur popullsinë e mbuluar me shërbim dhe koston kapitale njësi për frymë. Meqenëse sistemet aktuale, përveç dy të tillave, nuk kanë asete të trajtimit të ujërave të zeza, vlera për frymë e kanalizimeve është reduktuar për të reflektuar “vetëm rrjetin”. Për këto dy vlera është aplikuar një përqindje për të nxjerrë një vlerë për “zëvendësim të menjëhershëm”, ku periudha e “menjëhershme” është 10 vjet. Rezultati është një investim kapital i përvitshëm për ripërtëritjen, riparimin dhe zëvendësimin prej 58,872,800 lekësh.

Tabela 4-3

#### NEVOJAT KAPITALE PËR INVESTIMET E SHTYRA NË MENAXHIMIN E ASETEVE

Objekti	Njësi	Vlera
Popullsia aktuale me shërbim ujësjellës-kanalizimesh	Nr. i njerëzve	2 594 926
Popullsia aktuale me shërbim kanalizimesh	Nr. i njerëzve	1 495 789
Kosto kapitale për njësi/frymë - ujësjellës	Lekë/frymë	420
Kosto kapitale për njësi/frymë - kanalizime (vetëm rrjeti)	Lekë/frymë	350
Vlera aktuale e zëvendësimit -ujësjellës	Lekë ('000)	1,089,870
Vlera aktuale e zëvendësimit - kanalizime	Lekë ('000)	523,526
% e shërbimit ujësjellës që kanë nevojë për zëvendësim të menjëhershëm	%	30%
% e kanalizimeve që kanë nevojë për zëvendësime të menjëhershme	%	50%
Vlera e zëvendësimeve të menjëhershme - ujësjellës	Lekë ('000)	326,961
Vlera e zëvendësimeve të menjëhershme - kanalizime	Lekë ('000)	261,764
Vlera totale e zëvendësimeve të menjëhershme	Lekë ('000)	588,724
Periudha e zëvendësimit	vite	10
Kapital vjetor i investimeve për ripërtëritje, riparim dhe zëvendësim	Lekë('000)/vit	58,873

#### 4.3 Nevojat kapitale për asistencë teknike

Shqipëria nuk ka kapacitete të mjaftueshme njerëzore në institucionet e saj për të zbatuar disa plane veprimi me natyrë jokapitale. Në këto raste, do të lindë nevoja për shpenzime kapitale në formën e asistencës teknike dhe relativisht për programe kompjuterike. Këto shpenzime të veçanta figurojnë në disa plane veprimi dhe përmbliken më poshtë në tabelën 4-4, me afate kohore të parashikuara përgjatë periudhës së planifikimit.

Tabela 4-4

**NEVOJAT KAPITALE PËR ASISTENCË TEKNIKE  
(NË 000 LEKË)**

Nr.	Asistencë teknike	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	Total
1.e.	Vrojtimi i vlerësimit të nevojave që kryhet dy herë në vit		700,000						700,000
2.c.	Ngritja e sistemeve për menaxhimin e asetëve			1,400,000					1,400,000
3.c.	Hartimi dhe përhapja e një kontrate tip për dhënien e shërbimeve		350,000	350,000					700,000
3.d.	Forcimi i drejtorisë së përgjithshme si sekretariat teknik dhe i agjencive të baseneve të lumenjve		1,400,000	1,400,000					2,800,000
4.a.	Programi i trajnimit dhe certifikimit			1,400,000	1,400,000	1,400,000			4,200,000
5.b.	Hartimi i ligjit për shërbimet e sektorit			700,000					700,000
5.c.	Iniciativat e para për procesin e bashkimit të ndërmarrjeve		2,800,000	2,800,000	2,800,000	2,800,000	2,800,000	5,600,000	19,600,000
	<b>Total</b>		<b>5,250,000</b>	<b>8,050,000</b>	<b>4,200,000</b>	<b>4,200,000</b>	<b>2,800,000</b>	<b>5,600,000</b>	<b>30,100,000</b>

#### 4.4 Investimi total kapital që nevojitet për periudhën e planifikimit

Në tabelën 4-6 paraqiten nevojat për investime kapitale në total për periudhën e planifikimit, duke marrë në konsideratë investimet e “reja” kapitale për arritjen e objektivave strategjike të deklaruar më lart: investimet kapitale për “riparim dhe zëvendësim”, si dhe investimet kapitale në formën e asistencës teknike.

Për zhvillimin e strategjisë, është e rëndësishme të krahasohet kapitali total për investime me programin buxhetor afatmesëm të qeverisë, me qëllim që të vlerësohet “hendeku” për investime dhe si mund të mbushet ky hendek.

Tabela 4-5 paraqet krahasimin me programin buxhetor afatmesëm për periudhën 2011-2013

Tabela 4-5  
KRAHASIMI I PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM  
ME NEVOJAT PËR KAPITAL TË STRATEGJISË SEKTORIALE (000 LEKË)

Buxheti/vlerësimi	2011	2012	2013
Programi buxhetor afatmesëm	84,000,000	92,400,000	111,580,000
Nevojat për kapital të strategjisë sektoriale	104,761,828	170,727,650	163,732,711

Siç paraqitet në tabelën 4-5, programi buxhetor afatmesëm për shpenzimet kapitale është më i vogël se vlerësimi për shpenzime kapitale të nevojshme të identifikuar në këtë strategji. Ky vlerësim mund të rregullohet duke vendosur objektiva më të ulëta gjatë viteve të para të planifikimit strategjik. Është interesante, sepse pjesa më e madhe e nevojave për fonde shitesë përbëhet nga vlera e përllogaritur për “ripërtëritje, riparim dhe zëvendësim kapitali”, ose e thënë ndryshe, mirëmbajtja kapitale e përealizuar në të kaluarën.

Tabela 4.6  
INVESTIMI TOTAL KAPITAL QË NEVOJITET PËR PERIUDHËN E PLANIFIKIMIT  
(NË 000 LEKË)

Asistencë teknike	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	Total
Investime të reja kapitale	45,889,028	106,604,850	96,809,911	88,901,935	90,959,006	100,190,874	97,999,772	627,355,374
Investime kapitale për riparime dhe zëvendësime	58,872,800	58,872,800	58,872,800	58,872,800	58,872,800	58,872,800	58,872,800	412,109,600
Kapitali për asistencën teknike	-	5,250,000	8,050,000	4,200,000	4,200,000	2,800,000	5,600,000	30,100,000
<b>Totali</b>	<b>104,761,828</b>	<b>170,727,650</b>	<b>163,732,711</b>	<b>151,974,735</b>	<b>154,031,806</b>	<b>161,863,674</b>	<b>162,472,572</b>	<b>1,069,564,974</b>

## KAPITULLI 5 PËRGJEGJSHMËRIA, MONITORIMI DHE VLERËSIMI

Ky kapitull i strategjisë sektoriale përshkruan përjasjen e qeverisë në lidhje me përgjegjshmërinë, monitorimin dhe vlerësimin e strategjisë gjatë gjithë zbatimit të saj. Qeveria ka për qëllim që për secilin plan veprimi prioritar të përshkruar nën secilën prej pesë objektivave të misionit, të mbahet përgjegjshme direktë.

### 5.1 Përgjegjshmëria

Siç paraqitet në kapitullin 4, për çdo plan veprimi prioritar është caktuar një institucion përgjegjës. Edhe kur lind nevoja që një plan veprimi prioritar i caktuar të kryhet nga një grup pune i përbashkët, një nga anëtarët e këtij grupi pune të përbashkët është caktuar të jetë institucioni përgjegjës drejtues.

Institucioni përgjegjës duhet të hartojë një plan zbatimi më të detajuar për secilin nga planet e veprimit prioritar që i janë caktuar, ku përshkruhet sesi ky institucion ka për qëllim të ushtrojë autoritetin dhe përgjegjësinë për të arritur treguesit e synuar të performancës që mbështesin secilin nga objektivat strategjike. Këto plane të detajuara zbatimi fillojnë të zbatohen dy muaj pas miratimit të strategjisë sektoriale nga Këshilli i Ministrave.

### 5.2 Monitorimi

Përgjegjësinë për monitorimin e progresit gjatë zbatimit të strategjisë sektoriale e ka Drejtoria e Përgjithshme e Politikave të Ujësjellës-Kanalizimeve dhe Mbetjeve të Ngurta në Ministrinë e Punëve Publike dhe Transportit. Pjesa më e madhe e monitorimit do të mbulohet nga puna rutinë e Njësisë së Monitorimit të Treguesve të Punës dhe Vlerësimit Krahasues në Drejtorinë

e Përgjithshme të Ujësjetllës-Kanalizimeve. Megjithatë, në ato situata kur institucioni përgjegjës është jashtë Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit, Drejtoria e Përgjithshme e Politikave të Ujësjetllës-Kanalizimeve dhe Mbetjeve të Ngurta duhet të bashkëpunojë me institucionin përgjegjës, për të gjetur një mënyrë praktike për kryerjen e monitorimit.

Drejtoria e Përgjithshme e Politikave të Ujësjetllës-Kanalizimeve dhe Mbetjeve të Ngurta do të përgatisë një raport monitorimi gjashtëmuor dhe vjetor për të gjitha planet e veprimit prioritarë dhe qëllimet strategjike të përcaktuara, bazuar në raportet me shkrim të institucionit përgjegjës.

### 5.3 Vlerësimi

Drejtoria e Përgjithshme e Politikave të Ujësjetllës-Kanalizimeve dhe Mbetjeve të Ngurta do të organizojë një takim vlerësimi me grupin e punës pas nxjerrjes së raporteve të monitorimit gjashtëmuor dhe vjetor, për të diskutuar progresin e bërë gjatë zbatimit të strategjisë sektoriale dhe për të identifikuar ndryshimet e mundshme në planet e veprimit dhe qëllimet strategjike të synuara.

Drejtoria e Përgjithshme e Politikave të Ujësjetllës-Kanalizimeve dhe Mbetjeve të Ngurta do të përgatitë një vlerësim përfundimtar për vitin pararendës pas vendimeve të marra nga grupi i punës.

**Strategjia e furnizimit me ujë dhe kanalizimeve, 2011-2017**

**Objektivat prioritarë dhe indikatorët**

Pr. obj. ind.	Objektivi i politikës	Indikatori faktik në vitin 2009	Planifikimi për vitin e fundit 2010	Planifikimi për vitin e fundit 2011	Planifikimi për vitin e fundit 2012	Planifikimi për vitin e fundit 2013	Planifikimi për vitin e fundit 2014	Planifikimi për vitin e fundit 2015	Planifikimi për vitin e fundit 2016	Planifikimi për vitin e fundit 2017
1	Përshkrimi i objektivit									
	Zgjerimi dhe përmirësimi i cilësisë së shërbimeve të furnizimit me ujë, dhe kanalizimeve									
1.a.1	Indikatori									
	Mbulimi me ujësjellës për zonën urbane	89.8%	90.7%	91%	92%	93%	94%	95%	96%	98%
1.a.2	Indikatori									
	Mbulimi me ujësjellës për zonën rurale	57.0%	57.0%	60%	64%	70%	76%	79%	82%	85%
1.b.1	Indikatori									
	Mbulimi me kanalizime për zonën urbane	81.7%	83.0%	83%	84%	85%	85%	86%	87%	87%
1.b.2	Indikatori									
	Mbulimi me kanalizime për zonën rurale	10.9%	10.9%	11%	13%	15%	20%	25%	35%	45%
1.c.1	Indikatori									
	Vazhdimësia e shërbimit të furnizimit me ujë (orë/ditë)	10.8 (orë/ditë)	11.1 (orë/ditë)	12 (orë/ditë)	13 (orë/ditë)	14 (orë/ditë)	15 (orë/ditë)	16 (orë/ditë)	18 (orë/ditë)	20 (orë/ditë)
1.d.1	Indikatori									
	Mbulimi me shërbim të trajtimit të ujrave të ndotura me impiante trajtimi	1.0%	4.0%	7%	15%	20%	25%	30%	35%	40%
1.e.1	Indikatori									
	Të zhvillojë dhe të kryejë periodikisht një vëzhgim të nevojave kombëtare, i cili do t'i japë prioritet projekteve për investime						100%	100%	100%	100%



**Strategjia e furnizimit me ujë dhe kanalizimeve, 2011-2017**

**Objektivat prioritarë dhe indikatorët**

Pr. obj. ind.	Objektivi i politikës	Indikatori faktik në vitin 2009	Planifikimi për vitin e fundit 2010	Planifikimi për vitin e fundit 2011	Planifikimi për vitin e fundit 2012	Planifikimi për vitin e fundit 2013	Planifikimi për vitin e fundit 2014	Planifikimi për vitin e fundit 2015	Planifikimi për vitin e fundit 2016	Planifikimi për vitin e fundit 2017
2	Përshkrimi i oobjektivit									
	Orientimi i shoqërive të furnizimit me ujë dhe kanalizime për të operuar, bazuar në principet kryesore të kontrollit të kostove dhe mbulimit të plotë të tyre									
2.a.1	Indikatori									
	Mbulimi i koston direkte të operimit (KDO) me të ardhurat	84.3%	93.4%	95%	95%	100%	100%	100%	100%	100%
2.a.2	Indikatori									
	Mbulimi i koston direkte të operimit (KDO) me arkëtimet	63.1%	78.6%	80%	85%	90%	100%	100%	100%	100%
2.a.3	Indikatori									
	Mbulimi i koston totale të operimit (KDO) me të ardhurat	62.2%	66.6%	68%	70%	72%	74%	76%	78%	80%
2.a.4	Indikatori									
	Mbulimi i koston totale të operimit (KDO) me arkëtimet	46.5%	56.1%	58.5%	61.6%	64.8%	68.1%	71.4%	74.9%	78.4%
2.a.5	Indikatori									
	Mbulimi i fondit rezervë të kapitalit (riparim/zëvendësim dhe kapitali i ri) për sektorin me të ardhura	0%	0%	0%	0%	10%	20%	30%	40%	50%
2.a.6	Indikatori									
	Norma e përgjithshme e arkëtimit	74.8%	84.2%	86%	88%	90%	92%	94%	96%	98%
2.b.1	Indikatori									
	Reduktimi i nivelit të ujit pa të ardhura	70.0%	63.2%	60%	57%	54%	51%	48%	45%	40%

		Indikator									
	2.b.2	Niveli i matjes së konsumit të ujit i shprehur si numër lidhjesh	44.1	44.6%	48.0%	52.0%	60.0%	65%	72%	80%	85%
		Indikator									
	2.b.3	Niveli i matjes së prodhimit të ujit i shprehur si numër lidhjesh	15.7%	16.0%	30%	60%	90%	100%	100%	100%	100%
		Indikator									
	2.b.4	Niveli i matjes së shpërndarjes së ujit i shprehur si numër lidhjesh	11.9%	12.0%	13%	30%	60%	90%	100%	100%	100%
		Indikator									
	2.c.1	Zhvillimi i një programi për një sistem menaxhimi asetesh plotësisht të dokumentuara në të gjitha shoqëritë e licencuara					100%	100%	100%	100%	100%
		Indikator									
	2.d.1	Të kërkojë nga të gjitha shoqëritë e licencuara, të zhvillojnë dhe përditësojnë çdo vit një plan biznesi pesëvjeçar					100%	100%	100%	100%	100%
		Indikator									
	2.e.1	Të zhvillojë dhe implementojë një program subvencionesh për shtresat në nevojë					100%	100%	100%	100%	100%

**Strategjia e furnizimit me ujë dhe kanalizimeve, 2011-2017**

**Objektivat prioritarë dhe indikatorët**

Pr. obj. ind.	Objektivi i politikës	Indikatori faktik në vitin 2009	Planifikimi për vitin e fundit 2010	Planifikimi për vitin e fundit 2011	Planifikimi për vitin e fundit 2012	Planifikimi për vitin e fundit 2013	Planifikimi për vitin e fundit 2014	Planifikimi për vitin e fundit 2015	Planifikimi për vitin e fundit 2016	Planifikimi për vitin e fundit 2017
3	Përshkrimi i objektivit									
	Përmirësimi i qeverisjes dhe kuadrit ligjor në sektor									
3.a.1	Indikatori									
	Konsolidimi i mëtejshëm i rolit dhe funksionit të Entit Rregullator të Ujit			50%	75%	100%	100%	100%	100%	100%
3.b.1	Indikatori									
	Përfundimi i procesit të licencimit i të gjithë operatorëve të sistemit të furnizimit me ujë e kanalizime				50%	100%	100%	100%	100%	100%
3.c.1	Indikatori									
	Hartimi dhe përhapja e një kontrate tip për dhënie e shërbimeve			50%	100%	100%	100%	100%	100%	100%
3.d.1	Indikatori									
	Të forcojë rolin e sekretariatit teknik të Këshillit Kombëtar të Ujit dhe agjencive të baseneve ujore				50.0%	75.0%	100%	100%	100%	100%
4	Përshkrimi i objektivit									
	Rritja e kapaciteteve të stafit menaxhues, të operimit dhe mirëmbajtjes, të shoqërive të furnizimit me ujë nëpërmjet zhvillimit dhe zbatimit të programeve të trajnimit të certifikuara									
4.a.1	Indikatori									
	Orët e trajnimit të stafit në vit (orë/vit/person)			1 orë në vit	4 orë në vit	8 orë në vit	16 orë në vit	24 orë në vit	32 orë në vit	40 orë në vit
4.a.2	Indikatori									
	Numri i stafit drejtues të trajnuar dhe të certifikuar për pozicionet e punës			0	0	25	75	150	150	150

4.b.1	Indikator									
	Të kërkojë që të gjithë anëtarët e këshillave mbikëqyrës të shoqërive të licencuara, të ndjekin dhe përfundojnë një kurs trajnimi mbi rolet, detyrat, autoritetin dhe përgjegjësitë e tyre				100%	100%	100%	100%	100%	100%
5	Përshkrimi i objektivit									
	Përafrimi i legjislacionit shqiptar me direktivat e BE-së për furnizimin me ujë dhe kanalizime									
5.a.1	Indikator									
	Propozimi i legjislacionit të përafruar me direktivat e BE-së mbi sektorin për aprovim në parlamentin e Shqipërisë				50%	50.0%	100%	100%	100%	100%
5.b.1	Indikator									
	Të konsiderojë dhe zhvillojë një ligj të ri specifik për sektorin e furnizimit me ujë dhe shërbimit të kanalizimeve			50%	100%	100%	100%	100%	100%	100%
5.c1	Indikator									
	Shoqëri anonime U-K rajonale	57	57	57	50	45	40	35	30	26

0.4% - Norma vjetore e rritjes së popullsisë (INSTAT)

**VENDIM**  
**Nr.649, datë 14.9.2011**

**PËR PËRCAKTIMIN E LISTËS SË SPECIALITETEVE, NËNSPECIALITETEVE APO  
SPECIALITETEVE PLOTËSUESE PËR PROFESIONET E RREGULLUARA**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 13, të ligjit nr.10 171, datë 22.10.2009 “Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimIn e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Ministrit të Shëndetësisë, Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Ministrit për Inovacionin dhe TeKnologjinë e Informacionit e të Komunikimit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Miratimin e listës së specialiteteve, nënspecialiteteve apo specialiteteve plotësuese për profesionet e rregulluara, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Ministri për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit e të Komunikimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

Shtojca 1

**LISTA E SPECIALITETEVE, NËNSPECIALITETEVE APO SPECIALITETEVE PLOTËSUESE  
PËR PROFESIONET E RREGULLUARA**

- I. PROFESIONI I MJEKUT TË PËRGJITHSHËM (PA SPECIALITETE)
- II. PROFESIONI I STOMATOLOGUT (PA SPECIALITETE)
- III. PROFESIONI I FARMACISTIT (PA SPECIALITETE)
- IV. PROFESIONI I INFERMIERIT  
INFERMIERI E PËRGJITHSHME  
LOGOPEDI  
TEKNIK LABORATORI  
IMAZHERI
- V. PROFESIONI I FIZIOTERAPISTIT (PA SPECIALITETE)
- VI. PROFESIONI I MAMISË (PA SPECIALITETE)
- VII. PROFESIONI I VETERINERIT (PA SPECIALITETE)
- VIII. PROFESIONI I ARKITEKTIT  
ARKITEKTURË (DIPLOMË E CIKLIT TË DYTË OSE EKUIVALENTE ME TË)  
URBANISTIKË (DIPLOMË E CIKLIT TË DYTË OSE EKUIVALENTE ME TË)
- IX. PROFESIONI I INXHINIERIT (DIPLOMË E CIKLIT TË DYTË)  
INXHINIERI MEKANIKE-PROFILI KONSTRUKSIONE E MJETE LËVIZËSE  
INXHINIERI MEKANIKE – PROFILI ENERGJETIKE  
INXHINIERI MEKANIKE (DIPLOMË E CIKLIT TË DYTË OSE EKUIVALENTE ME TË)  
INXHINIERI ELEKTRIKE-PROFILI ELEKTROENERGJETIKE  
INXHINIERI ELEKTRIKE-PROFILI AUTOMATIZIM INDUSTRIE  
INXHINIERI NDËRTIMI – PROFILI STRUKTURIST

- INXHINIERI NDËRTIMI-PROFILI TRANSPORT  
 INXHINIERI NDËRTIMI-PROFILI GJEOTEKNIK  
 INXHINIERI MJEDISI-PROFILI TRAJTIM UJRASH  
 INXHINIERI MJEDISI-PROFILI ENERGJI  
 INXHINIERI NDËRTIMI (DIPLOMË E CIKLIT TË DYTË OSE EKUIVALENTE ME TË)  
 INXHINIERI MJEDISI (DIPLOMË E CIKLIT TË DYTË OSE EKUIVALENTE ME TË)  
 INXHINIERI HIDROTEKNIKE (DIPLOMË E CIKLIT TË DYTË OSE EKUIVALENTE ME TË)  
 INXHINIERI GJEODEZI (DIPLOMË E CIKLIT TË DYTË OSE EKUIVALENTE ME TË)  
 INXHINIERI GJEOLGJIKE-PROFILI GJEOLGJI INXHINIERIKE DHE HIDROGJEOLGJI  
 INXHINIERI GJEOFIZIKE  
 INXHINIERI E BURIMEVE NATYRORE-PROFILI GJEOMATIKE  
 GJEOLGJI (DIPLOMË E CIKLIT TË DYTË OSE EKUIVALENTE ME TË)  
 GJEOFIZIKË (DIPLOMË E CIKLIT TË DYTË OSE EKUIVALENTE ME TË)  
 INXHINIERI NAFTE (DIPLOMË E CIKLIT TË DYTË OSE EKUIVALENTE ME TË)  
 INXHINIERI MINIERA (DIPLOMË E CIKLIT TË DYTË OSE EKUIVALENTE ME TË)  
 INXHINIERI E PROCESVE KIMIKE  
 INXHINIERI NAVALE
- X. PROFESIONI I MËSUESIT (DIPLOMË E CIKLIT TË DYTË)  
 MËSUES PËR ARSIM FILLOR  
 MËSUES PËR ARSIMIN E MESËM TË ULËT  
 MËSUES PËR ARSIMIN E MESËM TË LARTË

**VENDIM**  
**Nr.650, datë 14.9.2011**

**PËR LICENCIMIN E AKADEMISË SË STUDIMEVE TË APLIKUARA “REALD”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4, pika 2,43,44 e 45, të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Licencimin e akademisë së studimeve të aplikuar “REALD”, e cila do ta ushtrojë veprimtarinë e saj në qytetin e Vlorës.
2. Akademia e studimeve të aplikuar “Reald” do të organizohet në dy fakultete:
  - a) Fakultetin e Shkencave Mjekësore, që do të ofrojë programin e studimit të ciklit të parë në “Infermieri”, si dhe programet e integruara të studimit të ciklit të dytë në:
    - i) Stomatologji;
    - ii) Farmaci.
  - b) Fakultetin e Ekonomisë që do të ofrojë programet e studimit të ciklit të parë në:
    - i) Marketing;
    - ii) Financë;
    - iii) Menaxhim.

3. Akademia e studimeve të aplikuara “REALD” do të ofrojë programe studimi të ciklit të parë, në “Infermieri”, “Marketing”, “Financë”, “Menaxhim”, që do të realizohen me 180 kredite dhe me kohëzgjatje normale 3 (tri) vite akademike. Në përfundim të këtyre programeve të studimit do të lëshohet diplomë universitare “Bachelor”, përkatësisht në:

- a) Infermieri;
- b) Marketing;
- c) Financë;
- ç) Menaxhim.

4. Akademia e studimeve të aplikuara “REALD” do të ofrojë programe të integruara të studimeve të ciklit të dytë në “Stomatologji” dhe “Farmaci”, që do të realizohen me 300 kredite dhe kohëzgjatja normale e tyre është 5 (pesë) vite akademike. Në përfundim të këtyre programeve të studimit do të lëshohet diplomë universitare “Master i shkencave”, përkatësisht në:

- a) Stomatologji;
- b) Farmaci.

5. Akademia e studimeve të aplikuara “REALD” ta fillojë veprimtarinë mësimore për programet e studimeve, të përcaktuara në pikën 2, të këtij vendimi, pasi të ketë marrë, jo më vonë se tri javë para fillimit të vitit të ri akademik, lejen përkatëse nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës.

6. Ndryshimet në vendndodhje, plane, forma studimi dhe programe, si dhe në elemente të tjera të miratuara, bëhen pas miratimit nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës.

7. Akademia e studimeve të aplikuara “REALD”, Vlorë, duhet t’i nënshtrohet procesit të akreditimit institucional dhe të programeve të studimeve, brenda afateve të përcaktuara në ligjin në fuqi.

8. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për zbatimin e këtij vendimi dhe për kontrollin periodik të ligjshmërisë në institucion.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

**VENDIM**  
**Nr.651, datë 14.9.2011**

**PËR LICENCIMIN E AKADEMISË PROFESIONALE TË BIZNESIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4, pika 2, e 43, 44, 44/1 e 45, të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Licencimin e Akademisë Profesionale të Biznesit, e cila ushtron veprimtarinë në qytetin e Tiranës.

2. Akademia Profesionale e Biznesit organizohet në dy fakultete:

- a) Fakulteti i Ekonomisë;
- b) Fakulteti i Drejtësisë.

3. Format e studimeve në Akademinë Profesionale të Biznesit janë studime me kohë të plotë dhe studime me kohë të pjesshme.

4. Fakulteti i Ekonomisë ofron:

a) Programet e studimit të ciklit të parë, në përfundim të të cilit merret diploma “Bachelor” në “Ekonomi” në tri profile:

- i) Banka dhe institucione financiare;
- ii) Administrim biznesi;
- iii) Financë kontabilitet.

b) Programet e studimit të ciklit të dytë, në përfundim të të cilit merret diploma “Master profesional” në:

- i) Kontabilitet financë;
- ii) Menaxhim biznesi.

5. Fakulteti i Drejtësisë ofron:

a) Programet e studimit të ciklit të parë, në përfundim të të cilit merret diploma “Bachelor” në:

- i) Drejtësi;
- ii) E drejtë biznesi.

b) Programet e studimit të ciklit të dytë, në përfundim të të cilit merret diploma “Master i shkencave” në:

- i) E drejtë penale;
- ii) E drejtë civile dhe tregtare.

6. Akademia Profesionale e Biznesit, Tiranë fillon veprimtarinë mësimore për programet e studimit, të përcaktuara në pikat 3 dhe 4 të këtij vendimi, pasi të ketë marrë jo më vonë se tri javë para fillimit të vitit akademik, lejen përkatëse nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës.

7. Ndryshimet në vendndodhje, plane, forma studimi dhe programe, si dhe në elemente të tjera, të miratuara, bëhen pas miratimit nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

8. Akademia Profesionale e Biznesit, Tiranë, duhet t’i nënshtrohet procesit të akreditimit institucional dhe të programeve të studimit, brenda afateve të përcaktuara në ligjin nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe në aktet nënligjore në fuqi.

9. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Akademia Profesionale e Biznesit, Tiranë, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
Sali Berisha

**VENDIM**  
**Nr.654, datë 14.9.2011**

**PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË KOMUNËS POGON, TË QARKUT TË GJIROKASTRËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të komunës Pogon, të qarkut të Gjirokastrës, që transferohen në pronësi ose në përdorim të kësaj komune, sipas lidhjes 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Lista me 136 (njëqind e tridhjetë e gjashtë) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 978 (nëntëqind e shtatëdhjetë e tetë).

2. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe komuna Pogon për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
Sali Berisha



Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
1-8	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore	Në pronësi
9-10	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik	Në pronësi
11-29, 31-100	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e zhvillimit ekonomik	Në pronësi
101-206	Infrastrukturë (rrugë vendore)	Në pronësi
207-280	Troje të lira dhe hapësira publike të pazëna ndërmjet ndërtesave ose objekteve të çdo lloji	Në përdorim
281-283	Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive social-kulturore e sportive	Në pronësi
626	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e shërbimit social	Në pronësi
627-635	Varrezat publike	Në pronësi
636	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e mbrojtjes civile	
637,638,640,642,644,646,647, 649,650,652,653	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive)	Në përdorim
639,641,643,645,648,651,654, 655-658 (vetëm kanalet e treta)	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka joproduktive dhe kanale të treta)	Në pronësi
675-689	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushë e ujësjellës-kanalizimeve	Në pronësi

### UDHËZIM

Nr.622, datë 7.9.2011

### PËR REGJISTRIMIN E TITUJVE NË SHOQËRINË “QENDRA E REGJISTRIMIT TË AKSIONEVE” SHA TIRANË

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 119, pika 5 të ligjit nr.9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të pikës 4 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 13.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, të neneve 6 e 13 të ligjit nr.9879, datë 21.2.2008 “Për titujt”,

#### UDHËZOJ:

1. Shoqëritë aksionare, të cilat rezultojnë të regjistruara në regjistrin tregtar, përpara regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit (QKR), të ndryshimeve në lidhje me transferimin e aksioneve, kapitalin e regjistruar, numrin e aksioneve dhe/ose vlerën nominale të secilit aksion, kanë detyrimin e pasqyrimin të këtyre ndryshimeve në shoqërinë “Qendra e Regjistrimit të Aksioneve” sh.a.Tiranë.

2. Titull sipas formës juridike, janë ato të përcaktuara në nenin 3 të ligjit nr.9879, datë 21.2.2008 “Për titujt”. Detyrimi për regjistrimin e titujve (aksioneve) në shoqërinë “Qendra e Regjistrimit të Aksioneve” sh.a. Tiranë rrjedh nga pika 5 e nenit 119 të ligjit nr.9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

3. Në rastet e njoftimit pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit të transferimit të aksioneve, shoqëria aksionare do të njoftojë edhe listën e plotë të aksionarëve të regjistruar më parë në shoqërinë “Qendra e Regjistrimit të Aksioneve” sh.a. Tiranë. Shoqëria, së bashku me bilancin vjetor kontabël dhe raportin e auditimit, njofton listën e plotë të aksionarëve të regjistruar me të dhënat e tyre, të identifikimit për aksionet nominative, si dhe numrin e përgjithshëm të të gjithë aksionarëve të saj nga shoqëria “Qendra e Regjistrimit të Aksioneve”, sh.a. Tiranë.

4. Ngarkohet për zbatimin e këtij udhëzimi Qendra Kombëtare e Regjistrimit, shoqëria “Qendra e Regjistrimit të Aksioneve”, sh.a. Tiranë dhe shoqëritë aksionare të regjistruar në regjistrin tregtar.

5. Ky udhëzim dërgohet për botim në Fletoren Zyrtare.

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin e Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I EKONOMISË, TREGTISË  
DHE ENERGJETIKËS  
Nasip Naço

**VENDIM**  
**Nr.82, datë 13.9.2011**

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR PËRCAKTIMIN E TARIFËS SË PRODHIMIT TË  
ENERGJISË ELEKTRIKE NGA KESH SHA PËR PERIUdhËN E TRETË  
RREGULLATORE**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 26 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 18, 20 dhe 21 të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr.21, datë 18.3.2009, vendimit nr.77, datë 26.6.2008 “Për miratimin e metodologjisë së llogaritjes së tarifës për kompaninë publike të gjenerimit të energjisë elektrike”, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 13.9.2011, pasi shqyrtoi aplikimin e KESH sh.a për përcaktimin e tarifës për prodhimin e energjisë elektrike për periudhën e tretë rregullatore dhe relacionin e grupit të punës,

konstatoi se:

Aplikimi plotëson kryesisht kërkesat e përcaktuara në rregullat e ERE-s, për fillimin e procedurave të shqyrtimit të aplikimit për përcaktimin e tarifës për prodhimin e energjisë elektrike.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

**VENDOSI:**

1. Fillimin e procedurave për përcaktimin e tarifës së prodhimit të energjisë elektrike nga KESH sh.a. për periudhën e tretë rregullatore.

2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit për njoftimin e KESH sh.a.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**  
**Sokol Ramadani**

**VENDIM**  
**Nr.83, datë 13.9.2011**

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR PËRCAKTIMIN E TARIFËS SË ENERGJISË  
ELEKTRIKE PËR FURNIZUESIN PUBLIK ME SHUMICË PËR PERIUdhËN E TRETË  
RREGULLATORE**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 26 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 20, 21 të Rregullave të Praktikës dhe procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr.21, datë 18.3.2009, vendimit nr.78, datë 26.6.2008 “Për miratimin e metodologjisë së llogaritjes së tarifës për furnizuesin publik me shumicë të energjisë elektrike”, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 13.9.2011, pasi shqyrtoi aplikimin e KESH sh.a për përcaktimin e tarifës të energjisë elektrike për furnizuesin publik me shumicë, për periudhën e tretë rregullatore dhe relacionin e grupit të punës,

konstatoi se:

Aplikimi plotëson kryesisht kërkesat e përcaktuara në rregullat e ERE-s, për fillimin e procedurave të shqyrtimit të aplikimit për përcaktimin e tarifës së energjisë elektrike për furnizuesin publik me shumicë.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

**VENDOSI:**

1. Fillimin e procedurave për përcaktimin e tarifës së energjisë elektrike për aktivitetin e furnizimit publik me shumicë për periudhën e tretë rregullatore.

2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit për njoftimin e KESH sh.a.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**  
**Sokol Ramadani**

**VENDIM**  
**Nr.84, datë 13.9.2011**

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR PËRCAKTIMIN E TARIFËS SË  
TRANSMETIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA OST SHA PËR PERIUdhËN E  
TRETË RREGULLATORE**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 26 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 18, 20 dhe 21 të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr.21, datë 18.3.2009, vendimit nr.59, datë 29.12.2005 “Për miratimin e metodologjisë së llogaritjes së tarifës së transmetimit të energjisë elektrike”, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 13.9.2011, pasi shqyrtoi aplikimin e OST sh.a. për përcaktimin e tarifës të transmetimit të energjisë elektrike për OST sh.a për periudhën e tretë rregullatore dhe relacionin e grupit të punës,

konstatoi se:

Aplikimi plotëson kryesisht kërkesat e përcaktuara në rregullat e ERE-s, për fillimin e procedurave të shqyrtimit të aplikimit për përcaktimin e tarifës së transmetimit të energjisë elektrike.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave për përcaktimin e tarifës të transmetimit të energjisë elektrike për OST sh.a. për periudhën e tretë rregullatore.
2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit për njoftimin e OST sh.a. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.  
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI  
Sokol Ramadani

**VENDIM**  
**Nr.85, datë 13.9.2011**

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR PËRCAKTIMIN E TARIFËS SË SHPËRNDARJES  
SË ENERGISË ELEKTRIKE PËR PERIU DHËN E TRETË RREGULLATORE**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 26 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 18, 20, 21 të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr.21, datë 18.3.2009, vendimit nr.79, datë 26.6.2008 “Për miratimin e metodologjisë së llogaritjes së tarifës së shpërndarjes së energjisë elektrike”, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 13.9.2011, pasi shqyrtoi aplikimin e “CEZ Shpërndarje” sh.a për përcaktimin e tarifës të shpërndarjes së energjisë elektrike për periudhën e tretë rregullatore dhe relacionin e grupit të punës,

konstatoi se:

Aplikimi plotëson kryesisht kërkesat e përcaktuara në rregullat e ERE-s, për fillimin e procedurave të shqyrtimit të aplikimit për përcaktimin e tarifës të shpërndarjes.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave për përcaktimin e tarifës së shpërndarjes së energjisë elektrike për periudhën e tretë rregullatore.
2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit për njoftimin e “CEZ shpërndarje” sh.a.  
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.  
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI  
Sokol Ramadani

**VENDIM**  
**Nr.86, datë 13.9.2011**

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR PËRCAKTIMIN E TARIFËS SË FURNIZIMIT PUBLIK ME PAKICË TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA “CEZ SHPËRNDARJE” SHA PËR KONSUMATORËT TARIFORË PËR PERIUdhËN E TRETË RREGULLATORE**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 26 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 18, 20, 21 të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr.21, datë 18.3.2009, vendimit nr.80, datë 26.6.2008 “Për miratimin e metodologjisë së llogaritjes së tarifës për furnizuesin publik me pakicë të energjisë elektrike”, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 13.9.2011, pasi shqyrtoi aplikimin e “CEZ Shpërndarje” sh.a. për përcaktimin e tarifës së furnizimit publik me pakicë të energjisë elektrike nga “CEZ shpërndarje” sh.a. për konsumatorët tariforë, për periudhën e tretë rregullatore dhe relacionin e grupit të punës, konstatoi se:

Aplikimi plotëson kryesisht kërkesat e përcaktuara në rregullat e ERE-s, për fillimin e procedurave të shqyrtimit të aplikimit për përcaktimin e tarifës së furnizimit publik me pakicë të energjisë elektrike.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

**VENDOSI:**

1. Fillimin e procedurave për përcaktimin e tarifës së furnizimit publik me pakicë të energjisë elektrike nga “CEZ shpërndarje” sh.a. për konsumatorët tariforë për periudhën e tretë rregullatore.

2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit për njoftimin e “CEZ shpërndarje” sh.a.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**  
**Sokol Ramadani**

**KËRKESË**  
**Nr.4001/2, datë 27.9.2011**

**PËR SHPRONËSIM PUBLIK**

Ministria e Punëve Publike dhe Transportit shpall kërkesën për shpronësim për interes publik të pasurive të paluajtshme pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Ndërtim K/Rruga Nationale Laç-Patok (vazhdim)”.

Subjekti kërkues i këtij objekti është Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve. Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkohet të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur në bazë të vendimit nr.872, datë 12.12.2007 të Këshillit të Ministrave “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.138, datë 23.3.2000 të Këshillit të Ministrave “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronarët që kanë emrin në listën emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre lidhur me çmimin, sipërfaqen, titullin e pronësisë, apo llojin e pasurisë që kanë në pronësi, të shoqëruara me dokumentet përkatëse në ministrinë kompetente (Ministria e Punëve Publike dhe Transportit).

Ky publikim bëhet vetëm për pasurinë e llojit: arë.

Pronarët do të kompensohen për efekt shpronësimi pas miratimit të kërkesës për shpronësim nga Këshilli i Ministrave dhe pasi të kenë paraqitur dokumentacionin respektiv të pronësisë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve (subjekti kërkues në bazë të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimin dhe marrjen në përdorim të përkohshëm, të pasurisë pronë private për interes publik”).

Vlera totale e këtij shpronësimi është 3 359 630 (tre milionë e treqind e pesëdhjetë e nëntë mijë e gjashtëqind e tridhjetë) lekë.

MINISTRI I PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT  
**Sokol Olldashi**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E RRUGËVE  
SEKTORI I SHPRONËSIMEVE

LISTA E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN PËR EFEKT TË NDËRTIMIT TË SEGMENTIT  
RRUGOR “NDËRTIM K/RRUGA NACIONALE LAÇ-PATOK”

Qarku: Lezhë  
Fshati: Fshati Laç

Nr.	Pronari			ZK	Nr.pas	ARË			Shënime
	Emri	Atësia	Mbiemri			Sip.m <sup>2</sup>	Çmimi m <sup>2</sup>	Vlera në lekë	
1	Pren	Mark	Syziu	2365	3/9	1689	278	469542	Konfirmuar nga ZRPP
2	Pren	Mark	Syziu	2365	3/9	904	278	251312	Konfirmuar nga ZRPP
3	Gjon	Zef	Luka	2365	3/8	4256	278	1183168	Konfirmuar nga ZRPP
4	Bardhok	Zef	Prenga	2365	3/13	157	278	43646	Konfirmuar nga ZRPP
5	Dile		Syziu +BP	2365	4/3	3818	278	1061404	Konfirmuar nga ZRPP
6	Dile		Syziu +BP	2365	4/4	1261	278	350558	Konfirmuar nga ZRPP
	<b>Totali</b>					<b>12085</b>		<b>3359630</b>	

**KËRKESË**

Shtetasja Diana Ramizi (Ymeri) e bija e Nexhatit dhe e Tagjibes, lindur dhe banuese në Tiranë, në adresën: rruga “Agim Prodani” nr.7, kërkon pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, shpalljen të zhdukur të vëllait të saj, shtetasit Krenar Ymeraj.

**KËRKUESE**  
**Diana Ymeraj**

**Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.**  
Çmimi i abonimit pranë Postës Shqiptare, për Fletoret Zyrtare 2011, është 16 000 lekë.  
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

## BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI CIVIL	360 lekë
KODI I FAMILJES	310 lekë
KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE	90 lekë
KODI PENAL USHTARAK	55 lekë
KODI I PUNËS	140 lekë
KANONI I ZHURISË	40 lekë
PËRMBLEDHJE E VENDIMEVE TË GJYKATËS EUROPIANE	328 lekë
PËR TË DREJTAT E NJERIUT KUNDËR SHQIPËRISË	
PËRMBLEDHJE PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE	140 lekë
PËRMBLEDHJE VENDIMESH UNIFIKUESE TË GJYKATËS SË LARTË	512 lekë

Hyri në shtyp më 14.10.2011  
Doli nga shtypi më 17.10.2011

Tirazhi: 1700 copë

Formati: 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare  
Tiranë, 2011

Çmimi 56 lekë